



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 38

Tiranë – E hënë, 6 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 22.2.2017	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërviqeve të NATO-s, dhe të notës së pranimit për t'u bërë pjesë e këtij memorandumimi.....	2567
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 22.2.2017	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Së veriut, Shtabit të Komandantit Suprem të Aleatëve të Atlantikut dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/ stërviqeve të NATO-s, dhe të notës së pranimit për t'u bërë pjesë e këtij memorandumimi.....	2575
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 22.2.2017	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërviqeve të NATO-s dhe notës së pranimit për t'u bërë pjesë e këtij memorandumimi.....	2583
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 22.2.2017	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Portugalisë, Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërviqeve të NATO-s, dhe të notës së pranimit për t'u bërë pjesë e këtij memorandumimi.....	2592
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 22.2.2017	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë, Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandantit Suprem të Aleatëve të Atlantikut, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës, për kryerjen e operacioneve të NATO-s, dhe notës së pranimit për t'u bërë pjesë e këtij memorandumimi.....	2601



VENDIM

Nr. 121, datë 22.2.2017

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET
QEVERISË SË MBRETËRISË SË
BELGJIKËS DHE SHTABIT SUPREM TË
FUQIVE ALEATE NË EVROPË, NË
LIDHJE ME MBËSHTETJEN E SHTETIT
PRITËS PËR KRYERJEN E
OPERACIONEVE/STËRVITJEVE TË
NATO-S, DHE TË NOTËS SË PRANIMIT
PËR T'U BËRË PJESË E KËTIJ
MEMORANDUMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërvitjeve të NATO-s, dhe të notës së pranimit për t'u bërë pjesë e këtij memorandum, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BASHKËLIDHJE 4
PËR SH/SAGLEG/AM/04/16-312357
DATË 21 JANAR 2016

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI (MOU)
NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË SË
BELGJIKËS DHE SHTABIT SUPREM TË
FUQIVE ALEATE NË EVROPË NË LIDHJE
ME MBËSHTETJEN E SHTETIT PRITËS
PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE/
STËRVITJEVE TË NATO-S**

HYRJJE

Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës, e përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Shtabi Suprem i Fuqive Aleatëve në Evropë (SHAPE) më poshtë të referuar si Pjesëmarrësit:

duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949, dhe veçanërisht nenin 3 të saj;

duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes Ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik të Veriut dhe Shteteve të Tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (Pfp SOFA) të datës 19 qershor 1995 dhe duke përfshirë Protokollin Shtesë të kësaj Marrëveshjeje të datës 19 qershor 1995;

duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin e Atlantikut të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951;

duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtar të krijuar në bazë të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokollin i Parisit) të datës 28 gusht 1952;

duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën e NATO-s dhe kontrollit ose nëpërmjet territorit të Mbretërisë së Belgjikës gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të operacioneve të NATO-s;

duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve që parashikohen të ndodhin me NATO-n, Partneritetin për Paqe (Pfp) dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO;

dhe duke marrë parasysh nevojat e Mbretërisë së Belgjikës që më poshtë quhet Shteti Pritës, dhe nevojat e Komandës Supreme e Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), më poshtë referuar si Komanda Strategjike;

pjesëmarrësit kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm.

SEKSIONI I PARË

PËRKUFIZIME

Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve mbështetëse, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 Forcat – Të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO që përfshijn të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave siç përkufizohen tek NATO SOFA, Protokollin i Parisit dhe homologët Pfp. Termi përfshijn gjithashtu të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet, dhe municionin (në përputhje me kufizimet ligjore të HN-së), si dhe



burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, duke përfshirë kontraktuesit që dislokojnë ose mbështesin forcën.

1.2 Operacionet e NATO-s – Veprimet ushtarake, duke përfshirë stërvitjen ose kryerjen e misioneve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative të kryera nga forcat; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushate.

1.3 Komandant i NATO-s – Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s – Komandat ose repartet e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Komanda Ndërkombëtare – Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s. Përfshin aktivitetet që mund të jenë detashmente të përkohshme ose njësi të Komandave.

1.6 Komanda Kombëtare – Komandat e forcave kombëtare nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.7 Komanda Shumëkombëshe – Komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Shtete Dërguese (SNs) – Ato shtete dhe komanda ose elementët e tyre që angazhohen jashtë kufijve të tyre dhe në territorin e HN-së në mbështetje të operacioneve të NATO-s.

1.9 Shteti Pritës (HN) – Mbretëria e Belgjikës.

1.10 Komanda ose Komandantët Strategjikë (KK) – Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR), selia e të cilës është SHAPE.

1.11 Mbështetja e Shtetit Pritës (HNS)– Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në kohë paqeje, emergjence, krize, konflikti ose periudha të tensionit ndërkombëtar nga një Shtet Pritës forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë transit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës.

1.12 Mbrojtja e Forcës (FP) – Të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjediseve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

1.13 Shpenzimet – Ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e komandave, forcave kombëtare, shumëkombëshe ose ndërkombëtare ose të formacioneve të NATO-s. Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve të tij mbështetëse:

a) Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës.

b) Shpenzime të Përbashkëta – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e Shpenzimeve të Përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjen Teknike përkatëse dhe/ose Marrëveshjet e Përbashkëta të Zbatimit.

c) Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare – Ato shpenzime që konsiderohen të jenë përgjegjësi e një HN-je të vetëm.

1.14 Financim i Përbashkët i NATO-s – Fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për Shpenzimet e Zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të Operacioneve ose Stërvitjeve të specifikuar në të.

1.15 Notë Pranimi (NOA) – Një dokument që tregon synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të këtij MOU-je për një Operacion të specifikuar të drejtuar nga NATO.

1.16 Deklaratë Synimi (SOI) – Një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të kësaj MOU-je, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme apo jo për dhënien e HSN-së.

1.17 Marrëveshje Teknike (TA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe për një operacion të caktuar të drejtuar nga NATO. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dispozitat e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-së dhe SN(ve).

1.18 Marrëveshje e Përbashkët Zbatimi (JIA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe që vendos angazhimin ndërmjet palëve nënshkruese në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuar të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose kushtet e pagesës.



1.19 Komiteti Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët të Shtetit Pritës (JHNSSC) – Një komitet i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i bashkëkryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjithë SN-të, HN-ja dhe Komandanti i NATO-s takohen për të zhvilluar masat e nevojshme përforcuese në lidhje me HNS-në, si TA-ja dhe JIA(të), sipas rastit.

1.20 Vendet Operacionale – Vendet që ndodhen në territorin e HN-së për qëllimin e mbështetjes operacionale dhe/ose logjistike për forcën për operacionet e drejtuara nga NATO. Këto vende janë detashmente të një Komande Strategjike nën komandën e Komandantit të NATO-s.

1.21 Territori – Është territori i Mbretërisë së Belgjikës, duke përfshirë tokën, hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale dhe të brendshme të Mbretërisë së Belgjikës.

1.22 Përveç kur një kuptim specifikohet ndryshe në këtë MOU, zbatohet fjalori i NATO-s për Termat dhe Përkufizimet (AAP-6).

SEKSIONI I DYTË

QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij MOU-je është krijimi i politikës dhe procedurave për përcaktimin e vendeve operacionale dhe ofrimin e HNS-së tek forcat e NATO-s, ose të mbështetur nga HN-ja gjatë operacioneve të NATO-s.

2.2 Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga autoriteti përkatës i HN-së dhe nga komandantët e NATO-s duke parashikuar masat e HNS-së për një sërë operacionesh të NATO-s. Ky MOU zbatohet për të gjitha operacionet dhe stërvitjet pa dallim. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI I TRETË

OBJEKTI DHE MASA TË PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO-s ose PFP SOFA, Protokollit të Parisit dhe Protokollit tjetër Shtesë dhe çdo marrëveshje tjetër përkatëse që mund të jenë në fuqi ndërmjet SC-ve dhe HN-së zbatohen për të gjitha operacionet e NATO-s sipas rregullimit të këtij MOU-je.

3.2 HN-ja njih vendet operacionale të ngritura sipas këtij MOU-je si detashmente të SC-së krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmenteve si sipërmarrje të SC-së. Vendet që duhet të vendosen, identifikohen në dokumente pasuese. Masat e komandës dhe kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operacionale ose planet e stërvitjes.

3.3 Ky MOU synon të jetë në përputhje me doktrinën dhe politikën e NATO-s dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për HNS-në.

3.4 HN-ja do të japë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin, për forcat e dislokuara në operacionet e NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë.

3.5 Dispozitat e këtij MOU-je zbatohen në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti ose periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të përcaktohet reciprokisht nga HN-ja dhe autoritetet përkatëse të NATO-s.

3.6 Ndërsa SN-të dërguese inkurajohen të marrin pjesë në operacionet e NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je, si një dokument ombrellë sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja, marrëveshjet e veçanta bilaterale me shtetet individuale mund të merren parasysh nga HN-ja rast pas rasti.

3.7 HN-ja dhe SC-të mund të caktojnë përfaqësues për të negociuar dokumentet që mbështesin dhe zhvillojnë më tej këtë MOU.

3.8 Operacionet e drejtuara nga NATO të mbështetura nga ky MOU mund të kërkojnë operacione të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja pranon që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre në dhe përmes zonave territoriale të HN-së do të bëhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e operacionit. HN-ja do të administrojë/kontrolojë të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.

SEKSIONI I KATËRT

DOKUMENTET REFERUESE

4.1 Dokumentet referuese që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU ndodhen në aneksin A.



SEKSIONI I PESTË

PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij MOU-je

5.1 Shteti Pritës

a) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse dhe me ndodhjen e ndryshimeve dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja bën njoftim në kohën e duhur për Komandantin e NATO-s në lidhje me disponibilitetin ose ndonjë mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s bazohen tek dokumentet mbështetëse të përgatitura për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

b) Me qëllim që të jepet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja e siguruar me prokurim sigurohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues në përputhje me rregulloret e brendshme për prokurimet.

c) HN-ja mban regjistrat administrativë dhe financiarë të nevojshme për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohen për NATO-n, siç kërkohet nga qëllimet e auditimit.

d) Standardet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në përputhje me hollësitë e përcaktuara në dokumentet mbështetëse të këtij MOU-je.

e) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) HN-ja do të ofrojë, para çdo operacioni të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HN-së.

g) HN-ja do të ftojë SN-të të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një Note Pranimi ose Deklarimi Synimi (SOI).

h) HN-ja parashikon procedurat për lidhjet mjekësore ndërmjet HN-së dhe SN-së, duke përfshirë POC-të mjekësore.

i) HN-ja, (në bashkërendim me Komandantin e NATO-s) i jep forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/mjediset ushtarake të HN-së sipas të njëjta kushteve që u jep ushtarakëve të HN-së.

j) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse dhe pasuese, HN-ja do t'i japë Komandantit të NATO-s kopje të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie dhe mjedisore dhe bujqësore, që mund të zbatohet për operacionin e NATO-s, si dhe çdo rregulloreje në lidhje me ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme deh municioneve.

k) HN-ja pranon që kopjet e listës së mallrave të SN-së për pajisjet dhe furnizimet për përdorim ushtarak dhe personal në përputhje me NATO SOFA, do të jenë të mjaftueshme për qëllimet doganore.

5.2 Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe forcës që përcaktohet për një Plan Operacional (OPLAN), një Urdhër Operacional (OPORD) ose një Urdhër Operacional Stërvitor (EXOPORD) nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s i dërgon HN-së njoftim në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe propozon ndryshimin e dokumenteve mbështetëse dhe pasues, sipas rastit.

c) Komandanti i NATO-s përcakton nëse ofrohet Financimi i Zakonshëm dhe cilat kërkesa janë të përshtatshme për Financim të Zakonshëm.

d) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara të HNS-së dhe aprovon çmimet në lidhje me Shpenzimet e Zakonshme.

e) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga Financimi i Zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon në masën që është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve.

f) Nëse kërkesat e SN-ve janë në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira.

g) Komandanti i NATO-s identifikon personelin dhe kërkesat e tjera për operacionin e vendeve që caktohen në HN.



h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose tek JHNSSC-ja.

5.3 Shtetet Dërguese

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në duke pranuar dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një NOA-je ose duke nxjerrë një SOI për një operacion të caktuar të NATO-s.

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-s ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s.

c) Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga burimet ushtarake, përveç kur përdoren, siç është rënë dakord, procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

d) SN-të do të ofrojnë personel të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet.

e) SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave të HNS-së tek HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s kur ato kryhen dhe paraqet kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet.

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja.

g) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat e HN-së për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë që janë identifikuar për vendet operationale, si dhe çdo rregullore të HN-së për ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI I GJASHTË

MASA FINANCIARE

6.1 Me marrëveshje të ndërsjellë dhe/ose konventa ndërkombëtare, aktivitetet e Komandave Ndërkombëtare, vendet operationale, anijet, avionët ose automjetet në pronësi dhe/ose të kontraktuara nga NATO, POL dhe forcat e ofruara NATO-s janë të përjashtuara nga tatimet, detyrimet, pagesat shtetërore, tarifatat dhe të gjitha pagesat e ngjashme.

6.2 Protokollin e Parisit, Protokollin Tjetër Shtesë dhe e drejta zakonore ndërkombëtare që zbaton imunitetet dhe privilegjet e një Komande Ndërkombëtare do të zbatohet për çdo Komandë Ndërkombëtare, element ose detashment të komandës që mund të vendosen në HN-në pas zbatimit të një operacioni të drejtuar nga NATO.

6.3 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifatat ose pagesat e ngjashme nuk është e mundur, detyrimet vendosen në një nivel minimal por asnjëherë nuk vendosen në një normë më të lartë se ajo që zbatohet për Forcat e Armatosura të HN-së. Të gjitha shpenzimet duhet të përpunohen me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.

6.4 Transaksionet financiare që përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive në çdo institucion bankar privat ose qeveritar duhet të kryhen pa marrë asnjë pagesë apo tarifë të asnjë lloji në masën që është e mundur.

6.5 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me Financimin e Zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të operacionit të NATO-s. Të gjitha masat financiare që negociohen paraprakisht duhet të jenë specifike në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin Financim të Zakonshëm nga NATO.

6.6 Dokumentet pasuese ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

6.7 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të përballueshme nga Financimi i Zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SC-ja autorizon Financimin e Zakonshëm për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursos HN-në.

6.8 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime mund të identifikohen si Shpenzime të Përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshirë, mund të ndahen në përputhje me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara



në TA ose dokumente të tjerë mbështetës.

6.9 Për kërkesat e drejtpërdrejta të Shpenzimeve Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në bisedimet për HNS-të gjatë JHNSSC ose drejtpërdrejtë me HN-në nëse në JHNSSC nuk është ngritur. SN-të bëjnë pagesa të drejtpërdrejta ose rimbursime për HNS-në tek HN-ja vetëm për shërbimet e dhëna nga burimet ushtarake përveç kur është rënë dakord për përdorimin e procedurave të tjera të pagesës. Sipas masave kontraktuale të realizuara nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare dhe civile paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

6.10 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të dhëna nga HN-ja nuk vendosen me një normë më të lartë se ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së, dhe nuk përfshijnë shpenzime të tepërta administrative ose të tjera, por mund të reflektojnë përshtatje për shkak të grafikëve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose faktorëve të ngjashëm. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.

6.11 Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnizuesit tregtarë për furnizime, shërbime ose mbështetje tjetër.

6.12 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të operojnë pa siguracion tregtar.

6.13 HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose SN-së, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë paraprakisht nga një përfaqësues i autorizuar dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk jepet para se SC(të) ose SN(të), sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.

6.14 Nuk është dhënë financim në lidhje me këtë MOU dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Komandantit të NATO-s ose SN-ve. Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse.

6.15 Kaktimi i vendeve operacionale në mbështetje të një operacioni të NATO-s nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

6.16 Pajisjet, furnizimet, produktet dhe

materialet që importohen përkohësisht dhe ekspertoehen nga territori i HN-së në lidhje me operacionin e NATO-s përjashtohen nga të gjitha detyrimet, tatimet dhe tarifatat. Procedura të tjera doganore caktohen në përputhje me NATO-n ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit ose Protokollin Tjetër Shtesë, sipas rastit.

SEKSIONI I SHTATË

KONSIDERATA JURIDIKE

7.1 Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në përputhje me NATO ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë.

7.2 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin ose janë në lidhje me ekzekutimin e këtij MOU-je, dhe të tipit të trajtuar nga neni VII i NATO-s SOFA, trajtohen në përputhje me dispozitat e NATO ose Pfp SOFA.

7.3 Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen nga HN-ja në përputhje me procedurën e rregullimit të kontratave publike dhe në përputhje me ligjin e HN-së, me rimbursim nga Komanda e NATO-s ose SN-ja, sipas rastit.

7.4 SC(të) realizojnë ose delegojnë veprime juridike që janë thelbësore për përmbushjen e misionëve, duke përfshirë, pa u kufizuar në ushtrimin e kapacitetit për të lidhur kontrata, angazhuar në procedime gjyqësore ose administrative dhe blerje dhe disponim të pronës.

SEKSIONI I TETË

MBROJTJA E FORCËS

8.1 FP-ja e plotë dhe efektive planifikohet për komandën statike të NATO-s, operacionet, trajnimin dhe stërvitjet dhe detajohet në OPLANS, EXPI ose Masat Pasuese, sipas rastit. FP-ja zbatohet në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në një mënyrë që është në përputhje me NATO / Pfp SOFA. FP-ja nuk kërkohet në asnjë rrethanë të jetë në kundërshtim me NATO Pfp SOFA ose ligjet e HN-së.

8.2 Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

8.3 Sipas rastit, çdo SN është përgjegjës për identifikimin dhe parashikimin e kërkesave dhe kufizimeve të FP-së tek HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.



8.4 Përveç këtyre përgjegjësi të FP-së të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për FP-në, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin e të gjithë elementëve të kërkuar dhe të paraqitur për HN dhe SN FP-në, sipas rastit, për mbrojtjen e Forcës së tij.

SEKSIONI I NËNTË

SIGURIA DHE DEKLARIMI I INFORMACIONIT

9.1 Pjesëmarrësit dhe SN-të përmbushin procedurat e NATO-s për sigurinë në ruajtjen, trajtimin, transmetimin dhe garantimin e të gjithë materialit të klasifikuar që mbahet, përdoret, gjenerohet, ofrohet ose shkëmbehet.

9.2 Informacioni i dhënë nga një Pjesëmarrës ose SN një tjetri në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një Pjesëmarrës ose SN, i cili kërkon konfidencialitet ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikimi që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklaratimit, të barabartë me atë që kërkohej nga Pjesëmarrësi ose SN-ja.

9.3 Çdo Pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjitha hapat e ligshëm të mundshëm për moszbulimin e të gjithë informacionit të shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur Pjesëmarrësit ose SN-të bien dakord për këtë deklaratim.

9.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo Pjesëmarrës ose SN e shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim me një legjendë që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklaratimit, që informacioni lidhet me një operacion të NATO-s dhe që është dhënë në mirëbesim.

9.5 Vizitat nga personeli do të rregullohen në përputhje me procedurat e specifikuar në C-M(2002)49, i ndryshuar.

9.6 I gjithë informacioni dhe materiali i klasifikuar që i nënshtrohet dispozitave të këtij seksioni do të vazhdojë të mbrohet në rastin e tërheqjes së një Pjesëmarrësi ose pas prishjes së këtij MOU-je.

SEKSIONI I DHJETË

HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

10.1 Ky MOU hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit dhe mbetet në fuqi përveç

kur përfundohet nga një Pjesëmarrës duke bërë një njoftim me shkrim me afat gjashtë muaj para, drejtuar të gjithë Pjesëmarrësve të tjerë.

10.2 Të gjitha dispozitat e seksioneve 6, 7 dhe 9 mbeten në fuqi në rastin e tërheqjes së një Pjesëmarrësi ose të përfundimit të këtij MOU-je deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. SN-të përmbushin të gjitha detyrimet në rastin e prishjes apo tërheqjes.

SEKSIONI I NJËMBËDHJETË

NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI

11.1 Ky MOU mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë Pjesëmarrësve.

11.2 Konfliktet e dukshme në interpretimin dhe zbatimin e këtij MOU-je zgjidhen me konsultime ndërmjet Palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk i referohen asnjë gjykate kombëtare ose ndërkombëtare apo pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Ky MOU është nënshkruar në tri kopje, ku secila përmban tekstin në gjuhën angleze.

11.4 Problemet e përkthimit dhe interpretimit të këtij MOU-je do të zgjidhen sipas versionit të gjuhës angleze.

Sa më sipër përfaqëson marrëveshjet e arritura ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Europë, për çështjet e referuara në të.

NËNSHKRUAR:

Për Qeverinë e Republikës/Mbretërinë e Belgjikës

(vulë dhe firmë)

Emri

Titulli/grada

Datë 2 maj 2006

Në emër të Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropës

(firmë)

(shkrim dore i palexueshëm)

Emri

Titulli / grada

Datë 22 mars 2006

Mons, Belgjikë



ANEKSI A

DOKUMENTET REFERUESE

a) Traktati i Atlantikut të Veriut i datës 4 prill 1949

b) Dokumenti Kuadër i Partneritetit për Paqe i nxjerrë nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive që merrnin pjesë në Mbledhjen e Këshillit të Atlantik të Veriut (Dokument Kuadër), datë 10 janar 1994

c) Marrëveshje ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantik të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) e datës 19 qershor 1951

d) Marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin Forcave të tyre (PfP SOFA), e datës 19 qershor 1995

e) Protokoll i tjetër Shtesë i Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatit të Atlantik të Veriut dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokoll i Tjetër Shtesë), datë 19 dhjetor 1997

f) Protokoll i mbi Statusin e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare të krijuara në përputhje me Traktatin e Atlantik të Veriut (Protokoll i Parisit), i datës 28 gusht 1952

g) MC 319/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për logjistikën

h) MC 334/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për mbështetjen e Shtetit Pritës (HNS).

i) NATO STANAG-e të zbatueshme dhe direktivat politike për mbështetjen logjistike, mbrojtjen e forcës dhe rimbursimin financiar.

j) AJP-4.5 – Publikim i përbashkët i aleatëve për Doktrinën dhe Procedurat e Mbështetjes së Shtetit Pritës.

k) C-M (2002) 50 – Masat mbrojtëse për organet civile dhe ushtarake të NATO-s, forcat dhe njësitë (Asetet) e angazhuara të NATO-s kundër kërcënimeve terroriste.

l) BI-SC Direktiva e Mbrojtjes së Forcës 80-25, 1 janar 2003.

m) Bi-SC Udhëzim Planifikimi Funkcional për Mbrojtjen e Forcës.

n) AAP-6-Fjalori i termave.

o) C-M(2002) 49, Siguria Brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

NATO E PAKLASIFIKUAR

SHTOJCË 1

PËR SH/SAGLE/AM0416-312357

DATË 21 JANAR 16

NOTE PRANIMI

NOTË PRANIMI/DEKLARATË SYNIMI
PËR PJESËMARRJE NË MBËSHËTJETJEN E
SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË
FINANCIARE DHE TË TJERA TË
CAKTUARA BRENDA REPUBLIKËS/
MBRETËRISË SË _____(HN)
PËR OPERACIONIN/STËRVITJEN _____

Republika/Mbretëria/Qeveria/Ministri i
(SN)

i përfaqësuar nga

Pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në stërvitje dhe/ose operacionet në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë të miratuar nga Këshilli Atlantik të Veriut;

Duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërvitjes së NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s;

Me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së(Shteti Pritës), Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtetet e tjerë Dërgues në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë Stërvitjeve dhe Operacioneve në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë,

ZGJEDH TË MARRË PJESË DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E PËRFSHIRA NË:

“Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet (HN) Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë Operacionit/Stërvitjes, që ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit të fundit si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për aktivitetet ushtarake në lidhje me sipërmarrjet për Planin e Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së së përmendur më sipër.



Për Qeverinë e(SN)

Datë:

NATO E PAKLASIFIKUAR

VENDIM

Nr. 122, datë 22.2.2017

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET
QEVERISË SË MBRETËRISË SË
BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE
DHE IRLANDËS SË VERIUT, SHTABIT
TË KOMANDANTIT SUPREM TË
ALEATËVE TË ATLANTIKUT DHE
SHTABIT SUPREM TË FUQIVE ALEATE
NË EVROPË, NË LIDHJE ME
MBËSHTETJEN E SHTETIT PRITËS PËR
KRYERJEN E OPERACIONEVE/
STËRVITJEVE TË NATO-S, DHE TË
NOTËS SË PRANIMIT PËR T’U BËRË
PJESË E KËTIJ MEMORANDUMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Shtabit të Komandantit Suprem të Aleatëve të Atlantikut dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërvitjeve të NATO-s, dhe të notës së pranimi për t’u bërë pjesë e këtij memorandumi, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

BASHKËLIDHJE 7

PËRSH/SAGLEG/AM/04/16-312357

DATË 21 JANAR 2016

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI (MOU)
NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË SË
BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE
IRLANDËS SË VERIUT DHE SHTABIT, TË
KOMANDANTIT SUPREM TË ALEATËVE
TË ATLANTIKUT DHE SHTABIT SUPREM
TË FUQIVE ALEATE NË EVROPË NË
LIDHJE ME MBËSHTETJEN E SHTETIT
PRITËS PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE
/STËRVITJEVE TË NATO-S**

HYRJE

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Shtabit, të Komandantit Suprem të Fuqive Aleate të Atlantikut (HQ SACLANT) dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), më poshtë të referuar si Pjesëmarrësit:

Duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949, dhe veçanërisht nenin 3 të saj;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin e Atlantikut të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951;

Duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të krijuar në bazë të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokollit i Parisit) të datës 28 gusht 1952;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të Tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (PfP SOFA) të datës 19 qershor 1995;

Duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s për në ose nëpërmjet territorit të Mbretërisë së Bashkuar gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të operacioneve të NATO-s;

Duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve që parashikohen të ndodhin me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO; dhe

Duke marrë parasysh nevojat e Qeverisë ë



Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, që më poshtë quhet Shteti Pritës (HN), dhe nevojat e Shtabit, të Komandantit Suprem të Fuqive Aleate të Atlantikut (HQ SACLANT) dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), më poshtë të referuara individualisht dhe bashkërisht si Komanda Strategjike,

pjesëmarrësit kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

SEKSIONI I PARË

Përkufizime

Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve mbështetëse, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. Forcat – Të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO që përfshin të gjithë personelin, pajisjet, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave siç përkufizohen tek NATO SOFA, Protokollit i Parisit dhe homologët Pfp. Termi përfshin gjithashtu të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet, municionin dhe rezervat si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse.

2. Operacionet e NATO-s – Veprimet ushtarake, ose kryerjen e misioneve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese (stërvitore) ose administrative; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë lëvizjen, furnizimin, sulmin, mbrojtjen dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushate.

3. Mbështetja e Shtetit Pritës (HNS)– Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti nga një Shtet Pritës forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë transit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës.

4. Komanda ose Komandantët Strategjikë (KK) – Komandanti Suprem i Fuqive Aleate të Atlantikut (SACLANT), Komandanti Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR), selitë e të cilëve janë HQ SACLANT dhe SHAPE dhe, përkatësisht.

5. Mbrojtja e Forcës (FP) – Të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjediseve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha

situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

6. Komandant i NATO-s – Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

7. Organizatat e NATO-s – Komandat ose repartet e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

8. Komanda Ndërkombëtare – Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s. Përfshin aktivitetet që mund të jenë detashmente të përkohshme ose njësi të Komandave.

9. Komanda Kombëtare – Komandat e forcave kombëtare nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

10. Komanda Shumëkombëshe – Komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

11. Shtete Dërguese (SNs) – Një shtet ose element tjetër që angazhohen në territorin e SP-së në mbështetje të Operacioneve të NATO-s.

12. Financim i Përbashkët i NATO-s. – Fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për Shpenzimet e Zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të Operacioneve ose Stërvitjeve të specifikuar në të.

13. Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës.

14. Shpenzime të Përbashkëta – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e Shpenzimeve të Përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjet Teknike dhe/ose Marrëveshjet e Përbashkëta të Zbatimit.

15. Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare – Ato shpenzime që bëhen nga një shtet vetëm për mbështetjen e forcave të tij.

16. Notë Pranimi (NOA) – Një dokument që tregon synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të këtij MOU-je për një Operacion të specifikuar të drejtuar nga NATO.

17. Deklaratë Synimi (SOI) – Një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në



masat për HNS-në sipas dispozitave të kësaj MOU-je për një operacion të specifikuar të NATO-s, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme.

18. Marrëveshje Teknike (TA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe për një operacion të specifikuar të NATO-s. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dispozitat e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-së dhe SN(ve).

19. Marrëveshje e Përbashkët Zbatimi (JIA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe që vendos angazhimin ndërmjet SN-ve-së, ose elementeve të NATO-s me HN-në në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuar të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose kushtet e pagesës.

20. Komiteti Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët të Shtetit Pritës (JHNSC) – Një komitet i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i bashkëkryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjithë SN-të, HN-ja dhe Komandanti(ët) e NATO-s takohen për të zhvilluar masat e nevojshme përforcuese në lidhje me HNS-në, si TA-ja dhe JIA(të), sipas rastit.

21. Vendet Operacionale – Vendet që ndodhen në territorin e HN-së për qëllimin e mbështetjes operacionale dhe/ose logjistike për forcën për operacionet e NATO-s. Këto vende janë detashmente të një SC-je nën komandën e një Komandanti të NATO-s.

22. Përveç kur një kuptim specifikohet ndryshe në këtë MOU, zbatohet Fjalori i NATO-s për Termat dhe Përkufizimet (AAP-6).

SEKSIONI I DYTË

Qëllimi

1. Ky MOU identifikon parimet dhe procedurat për dhënien e HNS-së për forcat që gjenden, operojnë ose kalojnë transit nëpër territorin e HN-së, ujërat territoriale, hapësirën ajrore gjatë operacioneve të miratuara të NATO-s.

2. Ky MOU përcakton politikën dhe procedurat për përcaktimin e vendeve operacionale dhe ofrimin e HNS-së tek forcat e NATO-s, ose të mbështetur nga MB-ja gjatë Operacioneve të NATO-s.

3. Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin dhe ekzekutimin e masave HNS për një sërë operacionesh të NATO-s dhe zbatohet në rastet kur janë identifikuar forcat e angazhuara dhe për ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI I TRETË

Objekti

1. Ky MOU synon të jetë në përputhje me doktrinën dhe politikën e NATO-s dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për hyrjen e shpejtë të të gjitha forcave të NATO-s edhe për autorizimin nga HN-ja të dislokimit të forcës në territorin e HN-së për operacionet e NATO-s.

2. Dispozitat e NATO SOFA, Protokollit të Parisit dhe çdo marrëveshje tjetër përkatëse e që mund të jetë në fuqi ndërmjet SC-ve dhe HN-së zbatohen për të gjitha operacionet e NATO-s sipas këtij MOU-je.

3. HN-ja njih vendet operacionale të ngritura sipas këtij MOU-je si detashmente të SC-së krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmenteve si sipërmarrje të SC-së. Masat e komandës dhe kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operacionale.

4. HN-ja do të japë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë, që përfshijnë TA-në dhe JIA-të përkatëse.

5. Ky MOU synon të jetë në përputhje me të drejtën e HN-së dhe me çdo marrëveshje ndërkombëtare që mund të zbatohet.

6. Dispozitat e këtij MOU-je zbatohen në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti, siç mund të përcaktohet reciprokisht nga HN-ja dhe Autoriteti i NATO-s.

7. Operacionet e NATO-s të mbështetura nga ky MOU mund të kërkojnë operacione ajrore të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja pranon që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre do të bëhet në bazë të një lejeje të përgjithshme diplomatike për kohëzgjatjen e operacionit. HN-ja do të administrojë/kontrolojë të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.



8. Pjesëmarrësit mund të caktojnë përfaqësues dhe të delegojnë autoritetin për të negociuar masat HNS, që do të mbështesin dhe fuqizojnë këtë MOU.

9. Ndërsa SN-të inkurajohen të marrin pjesë në operacionet e NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je, si një dokument ombrellë sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja për një operacion specifik të NATO-s, marrëveshjet e veçanta bilaterale me shtetet individuale mund të vazhdojnë të zbatohen nëse pranohen në mënyrë të ndërsjellë.

SEKSIONI I KATËRT

DOKUMENTET REFERUESE

4.1 Dokumentet referuese që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU ndodhen në aneksin A.

SEKSIONI I PESTË

PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij MOU-je

5.1 Shteti Pritës

a) Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse të këtij MOU-je për një operacion specifik, HN-ja bën njoftim në kohën e duhur për Komandantin e NATO-s në lidhje me disponibilitetin ose ndonjë mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s bazohen tek dokumentet mbështetëse të përgatitura për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

b) Me qëllim që të jepet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja e siguruar me prokurim sigurohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues nga ofertuesi më i ulët i përshtatshëm.

c) HN-ja mban regjistrat administrativë dhe financiarë të nevojshme për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohen për NATO-n, siç kërkohet nga qëllimet e auditimit.

d) Standardet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në përputhje me hollësitë e përcaktuara në dokumentet mbështetëse.

e) HN-ja do të ftojë SN-të të pranojë dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një NOA-je ose SOI-je për qëllimet e një operacioni të specifikuar të NATO-s.

f) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

g) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse të këtij MOU-je, HN-ja do të vërë në dijeni dhe japë Komandantit të NATO-s dhe SN-ve kopje të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie dhe mjedisore dhe bujqësore, që mund të zbatohet për Operacionin e NATO-s si dhe çdo rregulloreje në lidhje me ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

h) HN-ja do të ofrojë, para çdo operacioni ose stërvitje të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HN-së.

i) HN-ja i jep forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/mjediset ushtarake të HN-së sipas të njëjta kushteve që u jep ushtarakëve të HN-së.

2. Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe forcës që përcaktohet për një Plan Operacional (OPLAN), një Urdhër Operacional (OPORD) ose një Urdhër Operacional Stërvitor (EXOPORD) nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s i dërgon HN-së njoftim në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe propozon ndryshimin e dokumenteve mbështetëse, sipas rastit.

c) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara të HNS-së dhe aprovon çmimet në lidhje me Shpenzimet e Zakonshme.

d) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga Financimi i Zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon në masën që është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve.

e) Komandanti i NATO-s përcakton nëse Financimi i Zakonshëm është i disponueshëm dhe cilat janë kërkesat e përshtatshme për financim të Zakonshëm.



f) Nëse kërkesat e SN-ve janë në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira.

g) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose tek JHNSSC-ja.

3. Shtetet Dërguese

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në duke pranuar dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një SOI për qëllimet e një operacioni të NATO-s.

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-s ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s.

c) Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga burimet ushtarake, përveç kur përdoren, siç është rënë dakord, procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

d) SN-të do të ofrojnë personel të përshtatshëm të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet. SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave të HNS-së tek HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s kur ato kryhen dhe paraqet kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet.

e) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat e HN-së për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë që janë identifikuar për vendet operacionale si dhe çdo rregullore për ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja.

SEKSIONI I GJASHTË

MASA FINANCIARE

1. Masat e financimit HNS, veçanërisht në lidhje me Financimin e Përbashkët të NATO-s varen nga rrethanat në atë kohë dhe mund të përcaktohen vetëm para zbatimit të një operacioni të NATO-s.

2. Nuk është dhënë financimin në lidhje me këtë MOU dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Pjesëmarrësve. Masat specifike financiare do të specifikohen në dokumentet mbështetëse. Megjithatë, vlejné parimet e përgjithshme të mëposhtme:

a) Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të përballueshme nga Financimi i Zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SC-ja autorizon, sipas rastit, Financimin e Zakonshëm për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursion HN-në.

b) Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime nuk kualifikohen si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s, këto shpenzime mund të identifikohen si Shpenzime të Përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshirë, mund të ndahen në përputhje me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara në TA/JIA ose dokumente të tjerë mbështetës.

c) HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose SN-së, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë paraprakisht nga një përfaqësues i autorizuar. Për më tepër, asnjë fond nuk jepet para se SC(të) ose SN(të), sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre për një operacion të caktuar të NATO-s.

d) Dokumentet mbështetëse ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

3. Nëse SN-të dihen për një operacion të specifikuar të NATO-s, procedurat për rimbursimin financiar të HN-së do të jenë ndërmjet HN-së dhe SN, dhe të detajuara në TA-të, JIA-të, sipas rastit.

4. Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake nuk vendosen me një normë më të lartë se ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së, dhe me masën më të vogël të kërkesave administrative, , por mund të reflektojnë përshtatje për shkak të skeduleve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose faktorëve të ngjashëm. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.



5. Komandat Ndërkombëtare, vendet operacionale dhe forcat e dhënë NATO-s janë, me mirëkuptim të ndërsjellë dhe sipas Konventës Ndërkombëtare, janë të lira nga tatime, detyrimet, tarifatat dhe pagesat si dhe detyrimet e tjera të ngjashëm në masën më të madhe të mundshme.

6. Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifatat ose pagesat e ngjashme nuk është e mundur, detyrimet nuk vendosen në një normë më të lartë se ajo që zbatohet për Forcat e Armatura të HN-së. Të gjitha shpenzimet duhet të përpuhohen me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.

7. Protokollin e Parisit dhe e drejta zakonore ndërkombëtare që zbaton imunitetet dhe privilegjet e një Komande Ndërkombëtare në HN-ë do të zbatohet për çdo Komandë të NATO-s, element ose detashment të komandës që mund të vendosen në HN-në në zbatim të një operacioni të NATO.

8. Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me Financimin e Zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të operacionit/stërvitjes së NATO-s. Të gjitha masat financiare që negociohen paraprakisht duhet të jenë specifike në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin financim të zakonshëm nga NATO.

9. Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnizuesit tregtarë për furnizime, shërbime ose mbështetje tjetër.

10. Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të operojnë pa siguracion tregtar.

11. Caktimi i vendeve operacionale në mbështetje të një operacioni të NATO-s nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

SEKSIONI I SHTATË

KONSIDERATA JURIDIKE

1. Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në përputhje me NATO ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit.

2. Masat për juridiksionin, që zbatohen për forcën, parashikohen në nenin VII të NATO SOFA. Ai ushtrohet brenda sistemit të zakonshëm

të drejtësisë penale që zbatohet për civilët.

3. Nëse një anëtar i forcës ndalohet, HN-ja duhet të njoftojë menjëherë përfaqësuesin e lartë të forcës.

4. Pajisjet, furnizimet, produktet dhe materialet që importohen përkohësisht dhe eksportohen nga territori i HN-së në lidhje me një operacion të NATO-s përjashtohen nga detyrimet, tatimet dhe tarifatat. Procedurat e tjera doganore përcaktohen në përputhje me SOFA dhe Protokollin e Parisit, sipas rastit.

5. SC(të) realizojnë ose delegojnë veprime juridike që janë thelbësore për përmbushjen e misioneve, duke përfshirë, pa u kufizuar në ushtrimin e kapacitetit për të lidhur kontrata, angazhuar në procedime gjyqësore ose administrative dhe blerje dhe disponim të pronës.

6. Pretendimet jokontraktuale trajtohen në përputhje me dispozitat e NATO SOFA.

7. Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen nga HN-ja në përputhje me procedurën e rregullimit të kontratave publike dhe në përputhje me ligjin e HN-së, me rimbursim nga Komanda e NATO-s ose SN-ja, sipas rastit.

SEKSIONI I TETË

MBROJTJA E FORCËS

1. FP-ja e plotë dhe efektive planifikohet për Komandën statike të NATO-s, operacionet, trajnimin dhe stërvitjet dhe detajohet në OPLANS, EXPI ose Masat Pasuese, sipas rastit. FP-ja zbatohet në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në një mënyrë që është në përputhje me NATO / Pfp SOFA. FP-ja nuk kërkohet në asnjë rrethanë të jetë në kundërshtim me NATO Pfp SOFA ose ligjet e HN-së.

2. Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

3. Sipas rastit, çdo SN është përgjegjës për identifikimin dhe parashikimin e kërkesave dhe kufizimeve të FP-së tek HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.

4. Përveç këtyre përgjegjësive të FP-së të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për FP-në, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin me HN-në e të gjithë elementëve të kërkuar dhe të paraqitur për HN dhe SN FP-në, sipas rastit, për mbrojtjen e Forcës së tij.



SEKSIONI I NËNTË

SIGURIA DHE DEKLARIMI I INFORMACIONIT

1. Informacioni i dhënë nga një Pjesëmarrës ose SN një tjetri në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një Pjesëmarrës, i cili kërkon konfidencialitet ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikimi që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklaramit, të barabartë me atë që kërkohet nga Pjesëmarrësi ose SN-ja.

2. Çdo Pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjitha hapat e ligjshëm të mundshëm për moszbulimin e të gjithë informacionit të shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur Pjesëmarrësit ose SN-të bien dakord për këtë deklaram.

3. Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo pjesëmarrës ose SN e shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim me një legjendë që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklaramit, që është dhënë në mirëbesim.

4. Pjesëmarrësit dhe SN-të sigurojnë që i gjithë materiali i klasifikuar që mbahet, përdoret, gjëndërohet, ofrohet ose shkëmbehet të ruhet, trajtohet, transmetohet dhe sigurohet në përputhje me dispozitat C-M (2002) 49, të datës 17 qershor 2002 “Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut”, e ndryshuar.

5. Vizitat nga personeli do të rregullohen në përputhje me procedurat e specifikuar në C-M(2002)49, i ndryshuar.

SEKSIONI I DHJETË

NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI

1. Ky MOU mund të ndryshohet në çdo kohë me shkrim me marrëveshjen e ndërsjellë të të gjithë Pjesëmarrësve. Ndryshimet duhet të nënshkruhen nga të gjithë Pjesëmarrësit dhe realizohen me shkëmbimin e mesazheve ose letrave që numërtohen sipas radhës.

2. Çdo konflikt në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij MOU-je zgjidhen me konsultime ndërmjet Pjesëmarrësve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk i referohen asnjë gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare apo pale të tretë për zgjidhje.

SEKSIONI I NJËMBËDHJETË

HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

1. Ky MOU hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit.

2. Ky MOU mbetet në fuqi përveç kur prishet nga një Pjesëmarrës, duke kryer një njoftim gjashtë muaj para me shkrim drejtuar Pjesëmarrësve të tjerë.

3. Në rast se ky MOU prishet:

a) dispozitat e seksioneve 6 (Financa), 7 (Ligjore), dhe 11 (Interpretimi) mbeten në fuqi derisa të realizohen të gjitha pagesat dhe pretendimet e prapambetura; dhe

b) dispozitat e seksionit 9 (Siguria dhe Deklarimi i Informacionit) mbeten në fuqi derisa ky informacion dhe materiali të kthehet tek Pjesëmarrësi i origjinës ose të asgjësohet.

4. Ky MOU nënshkruhet në tri kopje zyrtare në gjuhën angleze.

Sa më sipër përfaqëson marrëveshjet e arritura ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Komandave, Komandës Supreme Aleate Atlantike dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Europë, për çështjet e referuara në të.

NËNSHKRUAR:

Në emër të Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë

(firmë)

Sir Ian Garnett
Admiral, UK N
Shef Shtabi
Datë 10 shkurt 2003
Mons, Belgjikë

Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar
të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

(firmë)

Michael G. Wood CBE
Kundëradmiral, UK N
Drejtor i Operacioneve të Përgjithshme,
Organizimin e Logjistikës së Mbrojtjes së Komandës

Datë 22 qershor 2003



Për Shtabin e Komandantit Suprem të Fuqive
Aleate të Atlantikut

(firmë)

D.E. Miller
Nënadmiral, CA N
Shef Shtabi

Datë 11 Janar 2003
Norfolk, Virginia

ANEKSI A

DOKUMENTET REFERUESE

- a) Traktati Atlantik të Veriut i datës 4 prill 1949
- b) Marrëveshje ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantik të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) e datës 19 qershor 1951
- c) Marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantik të Veriut dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin Forcave të tyre (PfP SOFA), e datës 19 qershor 1995.
- d) Protokoll Tjetër Shtesë për Marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjerë që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e forcave të tyre (Protokolli Tjetër Shtesë), të datës 19 dhjetor 1997
- e) Protokoll mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të krijuara në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut (Protokolli i Parisit), i datës 28 gusht 1952
- f) MC 319/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për logjistikën.
- g) MC 334/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për mbështetjen e Shtetit Pritës (HNS).
- h) NATO STANAG-e të zbatueshme dhe Direktivat Politike për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcës dhe Rimbursimin Financiar. Veçanërisht STANAG 2034 – Procedurat Standarde të NATO-s për Asistencën Logjistike të Ndërsjellë dhe STANAG 3113 – Dhënia e Mbështetjes për Personelin vizitues, Avionët dhe Automjetet.
- i) AJP-4.5 – Publikim i Përbashkët i Aleatëve për Doktrinën dhe Procedurat e Mbështetjes së Shtetit Pritës, të përditësuar.
- j) C-M (2002) 50 – Masat mbrojtëse për Organet Civile dhe Ushtarake të NATO-s, Forcat dhe Njësitë (Asetet) e Angazhuara të NATO-s

kundër kërcënimeve terroriste.

k) BI-SC Direktiva e Mbrojtjes së Forcës 80-25, 1 janar 2003.

l) BI-SC Udhëzim Planifikimi Funkcional për Mbrojtjen e Forcës.

m) C-M(2002) 49, Siguria Brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, datë 17 qershor 2002.

n) AAP-6-Fjalori i termave

NATO E PAKLASIFIKUAR

SHTOJCË 1

PËR SH/SAGLE/AM0416-312357

DATË 21 JANAR 16

NOTË PRANIMI

NOTË PRANIMI/DEKLARATË SYNIMI PËR
PJESËMARRJE NË MBËSHTETJEN E
SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË
FINANCIARE DHE TË TJERA TË
CAKTUARA BRENDA REPUBLIKËS/
MBRETËRISË SË _____(HN)
PËR OPERACIONIN / STËRVITJEN_____

Republika/Mbretëria/Qeveria/Ministri i
(SN)

i përfaqësuar nga

Pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në stërvitje dhe/ose operacionet në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë të miratuar nga Këshilli Atlantik të Veriut.

Duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërvitjes së NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s,

Me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së(Shteti Pritës), Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtetet e tjerë Dërgues në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë Stërvitjeve dhe Operacioneve në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë.

ZGJEDH TË MARRË PJESË DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E PËRFSHIRA NË:



“Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet (HN) Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë Operacionit/Stërvitjes, që ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit të fundit si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për aktivitetet ushtarake në lidhje me sipërmarrjet për Planin e Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së së përmendur më sipër.

Për Qeverinë e (SN)

Datë:

NATO E PAKLASIFIKUAR

VENDIM

Nr. 123, datë 22.2.2017

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SLLOVENISË, SHTABIT SUPREM TË
FUQIVE ALEATE NË EVROPË DHE
SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME
ALEATE PËR TRANSFORMIMIN, NË
LIDHJE ME MBËSHTETJEN E SHTETIT
PRITËS PËR KRYERJEN E
OPERACIONEVE/STËRVITJEVE TË
NATO-S DHE NOTËS SË PRANIMIT
PËR T’U BËRË PJESË E KËTIJ
MEMORANDUMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërvitjeve të NATO-s dhe notës së pranimit për t’u bërë pjesë e këtij memorandum, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BASHKËLIDHJE 13
PËR SH/SALEG/AM/04/16-312357
DATË 21 JANAR 2016

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI (MOU)
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË SLLOVENISË (HN) DHE SHTABIT
SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË EVROPË
DHE SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME
ALEATE PËR TRANSFORMIMIN
NË LIDHJE ME MBËSHTETJEN E SHTETIT
PRITËS PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE
/STËRVITJEVE TË NATO-S**

PREAMBUL

Qeveria e Republikës së Sllovenisë (HN), e përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Shtabi Suprem i Fuqive Aleatëve në Evropë (SHAPE) dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT), më poshtë të referuar si Pjesëmarrësit:

Duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949, dhe veçanërisht nenin 3 të saj;

Duke pasur parasysh Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe të lëshuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive Pjesëmarrëse në Mbledhjen e Këshillit të Atlantikut të Veriut (Dokumenti Kuadër) të datës 10 janar 1994;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes Ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të Tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (PfP SOFA) të datës 19 qershor 1951 dhe duke përfshirë Protokollin Shtesë të kësaj Marrëveshjeje të datës 19 qershor 1995;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin e Atlantikut të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951;

Duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtar të krijuar në bazë të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokollin i Parisit) të datës 28 gusht 1952;

Duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit Tjetër Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve



Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (Protokolli Tjetër Shtesë), të datës 19 dhjetor 1997;

Duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën dhe kontrollin e NATO-s ose nëpërmjet territorit të Republikës së Sllovenisë (HN) gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të operacioneve të NATO-s;

Duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve që parashikohen të ndodhin me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PFP) dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO; dhe

Duke marrë parasysh nevojat e Republikës së Sllovenisë që më poshtë quhet Shteti Pritës, dhe nevojat e Komandës Supreme e Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT), më poshtë të referuara si Komanda Strategjike,

pjesëmarrësit kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve mbështetëse, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 Forcat – Në këtë MOU termi ‘forcat’ përfshin të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO që përfshin të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave siç përkufizohen tek NATO SOFA, Protokolli i Parisit dhe homologët PFP. Termi përfshin gjithashtu të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet dhe municionin, si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, duke përfshirë kontraktuesit që dislokojnë ose mbështesin forcën. Ai përfshin forcat që operojnë nën komandën ose kontrollin e NATO-s ose në mbështetje të operacioneve të NATO-s.

1.2 Operacionet e NATO-s – Veprimet ushtarake, duke përfshirë stërvitjen ose kryerjen e misioneve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative të kryera nga forcat; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushate.

1.3 Komandant i NATO-s – Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s – Komandat ose repartet e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Komanda Ndërkombëtare – Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s. Përfshin aktivitetet që mund të jenë detashmente të përkohshme ose njësi të Komandave.

1.6 Komanda Kombëtare – Komandat e forcave kombëtare nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.7 Komanda Shumëkombëshe – Komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Shtete Dërguese (SN) – Ato shtete dhe komanda ose elementët e tyre që angazhohen në territorin e SP-së në mbështetje të operacioneve të NATO-s.

1.9 Shteti Pritës (HN) – Republika e Sllovenisë.

1.10 Komanda ose Komandantët Strategjikë (KK) – Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR) dhe Komandanti Suprem i Aleatëve për Transformimin (SACT), selitë e të cilëve janë SHAPE dhe HQ SACT, përkatësisht.

1.11 Mbështetja e Shtetit Pritës (HNS)– Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti nga një Shtet Pritës forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë transit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës.

1.12 Mbrojtja e Forcës (FP) – Të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjedisve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

1.13 Shpenzimet – Ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e komandave, forcave kombëtare, shumëkombëshe ose formacioneve të NATO-s. Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve të tij mbështetëse:

a) Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës.



b) Shpenzime të Përbashkëta – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e Shpenzimeve të Përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjet Teknike dhe/ose Marrëveshjet e Përbashkëta të Zbatimit.

c) Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare – Ato shpenzime që konsiderohen të jenë përgjegjësi e një SP-je të vetëm.

1.14 Financim i Përbashkët i NATO-s – Fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për Shpenzimet e Zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të Operacioneve ose Stërviqeve të specifikuar në të.

1.15 Notë Pranimi (NOA) – Një dokument që tregon synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të këtij MOU-je për një Operacion të specifikuar të drejtuar nga NATO.

1.16 Deklaratë Synimi (SOI) – Një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të kësaj MOU-je, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme apo jo për dhënien e HNS-së.

1.17 Marrëveshje Teknike (TA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe për një operacion të drejtuar nga NATO. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dispozitat e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-së dhe SN(ve).

1.18 Marrëveshje e Përbashkët Zbatimi (JIA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe që vendos angazhimin ndërmjet palëve në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuar të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose kushtet e pagesës.

1.19 Komiteti Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët të Shtetit Pritës (JHNSSC) – Një komitet i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i bashkë-kryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjithë SN-të, HN-ja dhe Komandanti(ët) e NATO-s takohen për të zhvilluar masat e nevojshme përforcuese në lidhje me HNS-në, si TA-ja dhe JIA(të), sipas rastit.

1.20 Vendet Operacionale – Vendet që ndodhen në territorin e HN-së për qëllimin e

mbështetjes operacionale dhe/ose logjistike për forcën për operacionet e NATO-s. Këto vende janë detashmente të një Komande Strategjike (SC) nën komandën e një Komandanti të NATO-s.

1.21 Përveç kur një kuptim specifikohet ndryshe në këtë MOU, zbatohet Fjalori i NATO-s për Termat dhe Përkufizimet (AAP-6).

Neni 2 Qëllimi

2.1 Qëllimi i këtij MOU-je është krijimi i politikës dhe procedurave për përcaktimin e vendeve operacionale dhe ofrimin e HNS-së tek forcat e NATO-s, ose të mbështetur nga HN-ja gjatë operacioneve të NATO-s.

2.2 Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga autoriteti përkatës i HN-së dhe nga Komandantët e NATO-s duke parashikuar masat e HNS-së për një sërë operacionesh të NATO-s. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

Neni 3 Objekti dhe masa të përgjithshme

3.1 Dispozitat e NATO ose Pfp SOFA, Protokollit të Parisit, Protokollit Tjetër Shtesë dhe çdo Marrëveshje tjetër përkatëse që mund të jenë në fuqi ndërmjet SC-ve dhe HN-së zbatohen për të gjitha operacionet e NATO-s.

3.2 HN-ja njih vendet operacionale të ngritura sipas këtij MOU-je si detashmente të SC-së krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmenteve si sipërmarrje të SC-së. Vendet që duhet të vendosen, identifikohen në dokumente pasuese. Masat e komandës dhe kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operacionale ose stërvitore.

3.3 Ky MOU synon të jetë në përputhje me doktrinën dhe politikën e NATO-s dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për HNS-në.

3.4 HN-ja do të japë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin, për forcat e dislokuara në Operacionet e NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë.

3.5 Dispozitat e këtij MOU-je zbatohen në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti ose



periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të përcaktohet reciprokisht nga HN-ja dhe Autoritetet përkatëse të NATO-s.

3.6 Ndërsa SN-të dërguese inkurajohen të marrin pjesë në operacionet e NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je, si një dokument ombrellë sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja, marrëveshjet e veçanta bilaterale me shtetet individuale mund të merren parasysh nga HN-ja rast pas rasti.

3.7 HN-ja dhe SC-të mund të caktojnë përfaqësues për të negociuar dokumentet që mbështesin dhe zhvillojnë më tej këtë MOU.

3.8 Operacionet e NATO-s të mbështetura nga ky MOU mund të kërkojnë operacione ajrore të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja pranon që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre në dhe përmes zonave territoriale të HN-së do të bëhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e Operacionit. HN-ja do të administrojë/kontrollojë të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.

Neni 4

Dokumentet referuese

Dokumentet referuese që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU ndodhen në Aneksin A.

SEKSIONI I PESTË

PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij MOU-je

5.1 Shteti Pritës

a) Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse dhe me ndodhjen e ndryshimeve dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja bën njoftim në kohën e duhur për Komandantin e NATO-s në lidhje me disponibilitetin ose ndonjë mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s bazohen tek dokumentet mbështetëse të përgatitura për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

b) Me qëllim që të jepet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja

e siguruar me prokurim sigurohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues nga ofertuesi më i ulët i përshtatshëm.

c) HN-ja mban regjistrat administrativë dhe financiarë të nevojshme për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohen për NATO-n, siç kërkohet nga qëllimet e auditimit me mbështetje përkthimi, siç kërkohet.

d) Standardet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në përputhje me hollësitë e përcaktuara në dokumentet mbështetëse.

e) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) HN-ja do të ofrojë, para çdo operacioni të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HN-së.

g) HN-ja do të ftojë SN-të të pranojë dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një Note Pranimi ose Deklarimi Synimi.

h) HN-ja parashikon procedurat për lidhjet mjekësore ndërmjet HN-së dhe SN-së, duke përfshirë POC-të mjekësore.

i) HN-ja, (në bashkërendim me Komandantin e NATO-s), i jep forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/mjediset ushtarake të HN-së sipas të njëjta kushteve që u jep ushtarakëve të HN-së.

j) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse dhe pasuese, HN-ja do t'i japë Komandantit të NATO-s dhe SN-ve kopje të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie dhe mjedisore dhe bujqësore, që mund të zbatohet për Operacionin e NATO-s, si dhe çdo rregulloreje në lidhje me ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

5.2 Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe forcës që përcaktohet për një Plan Operacional (OPLAN), një Urdhër Operacional (OPORD) ose një Urdhër Operacional Stërvitor (EXOPORD) nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.



b) Komandanti i NATO-s i dërgon HN-së njoftim në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe propozon ndryshimin e dokumenteve mbështetëse, sipas rastit.

c) Komandanti i NATO-s përcakton nëse ofrohet Financimi i Zakonshëm dhe cilat kërkesa janë të përshtatshme për Financim të Zakonshëm.

d) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara të HNS-së dhe aprovon Shpenzimet e Zakonshme.

e) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga Financimi i Zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon në masën që është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve.

f) Nëse kërkesat e SN-ve janë në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira.

g) Komandanti i NATO-s identifikon personelin dhe kërkesat e tjera për vendet operacionale që caktohen në HN.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose tek JHNSSC-ja.

5.3 Shtetet Dërguese

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në duke pranuar dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një NOA-je ose duke nxjerrë një SOI për një operacion të caktuar të NATO-s.

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-s ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s.

c) Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga HN-ja, përveç kur përdoren, siç është rënë dakord, procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

d) SN-të do të ofrojnë personel të përshtatshëm të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet.

e) SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave të HNS-së tek HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s kur ato kryhen dhe i paraqet HNS-së kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet.

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja.

g) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat e HN-së për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë që janë identifikuar për vendet operacionale si dhe çdo rregullore të HN-së për ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

Neni 6

Masa financiare

6.1 Në përputhje me NATO dhe/ose PfP SOFA dhe protokollin e Parisit, konceptet e aprovuara HNS, aktivitetet e Komandave Ndërkombëtare, vendet operacionale, anijet, avionët ose automjetet në pronësi dhe/ose të kontraktuara nga NATO, POL dhe forcat e ofruara NATO-s janë të përjashtuara nga tatimet, detyrimet, pagesat shtetërore, tarifrat dhe të gjitha pagesat e ngjashme.

6.2 Protokollin e Parisit, Protokollin Tjetër Shtesë dhe e drejta zakonore ndërkombëtare që zbaton imunitetet dhe privilegjet e një Komande Aleate do të zbatohet për çdo Komandë Ndërkombëtare, element ose detashment të komandës që mund të vendosen në HN-në pas zbatimit të një operacioni të drejtuar nga NATO.

6.3 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifrat ose pagesat e ngjashme nuk është e mundur, detyrimet nuk vendosen në një normë më të lartë se ajo që zbatohet për Forcat e Armatosura të HN-së. Të gjitha shpenzimet duhet të përpunohen me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.

6.4 Transaksionet financiare që përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive në çdo institucion bankar privat ose qeveritar duhet të kryhen sipas ligjeve dhe rregulloreve të HN-së.

6.5 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me Financimin e Zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të Operacionit të NATO-s. Të gjitha masat financiare që negocohen paraprakisht duhet të jenë specifike



në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin Financim të Zakonshëm nga NATO.

6.6 Dokumentet mbështetëse ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

6.7 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të përballueshme nga Financimi i Zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SC-ja autorizon Financimin e Zakonshëm për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursos HN-në.

6.8 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime mund të identifikohen si Shpenzime të Përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshirë, mund të ndahen në përputhje me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara në TA ose dokumente të tjerë mbështetës.

6.9 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të dhëna nga HN-ja nuk vendosen me një normë më të lartë se ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së, dhe nuk përfshijnë shpenzime të tepërta administrative ose të tjera, por mund të reflektojnë përshtatje për shkak të skeduleve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose faktorëve të ngjashëm. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.

6.10 Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnizuesit tregtarë për furnizime, shërbime ose mbështetje tjetër.

6.11 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të operojnë pa siguracion tregtar.

6.12 HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose SN-së, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë paraprakisht nga një përfaqësues i autorizuar dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë

fond nuk jepet para se SC(të) ose SN(të), sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.

6.13 Nuk është dhënë financimin në lidhje me këtë MOU dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Komandantit të NATO-s ose SN-ve. Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse.

6.14 Caktimi i vendeve operationale në mbështetje të një operacioni të NATO-s nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

Neni 7

Konsiderata juridike

7.1 SC(të) realizojnë ose delegojnë veprime juridike që janë thelbësore për përmbushjen e misioneve, duke përfshirë, pa u kufizuar në ushtrimin e kapacitetit për të lidhur kontrata, angazhuar në procedime gjyqësore ose administrative dhe blerje dhe disponim të pronës.

7.2 Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në përputhje me NATO ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë.

7.3 Pajisjet, furnizimet, produktet dhe materialet që importohen përkohësisht dhe eksportohen nga territori i HN-së në lidhje me një Operacion të NATO-s përjashtohen nga detyrimet, tatimet dhe tarifatat. Procedurat e tjera doganore përcaktohen në përputhje me NATO Pfp SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë, sipas rastit.

7.4 Pretendimet jo-kontraktuale që rrjedhin ose janë në lidhje me ekzekutimin e këtij MOU-je trajtohen në përputhje me dispozitat e NATO ose Pfp SOFA.

7.5 Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen nga HN-ja në përputhje me procedurën e rregullimit të kontratave publike dhe në përputhje me ligjin e HN-së, me rimbursim nga Komanda e NATO-s ose SN-ja, sipas rastit.

Neni 8

Mbrojtja e forcës

8.1 FP-ja e plotë dhe efektive planifikohet për Komandën statike të NATO-s, operacionet, trajnimin dhe stërvitjet dhe detajohet në OPLANS, EXPI ose marrëveshjet plotësuese, sipas rastit. FP-ja zbatohet në përputhje me politikën dhe



procedurat e NATO-s dhe në një mënyrë që është në përputhje me NATO / Pfp SOFA. FP-ja nuk kërkohet në asnjë rrethanë të jetë në kundërshtim me NATO Pfp SOFA ose ligjet e HN-së.

8.2 Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

8.3 Sipas rastit, çdo SN është përgjegjës për identifikimin dhe parashikimin e kërkesave dhe kufizimeve të FP-së tek HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.

8.4 Përveç këtyre përgjegjësive të FP-së të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për FP-në, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin e të gjithë elementëve të kërkuar dhe të paraqitur për HN dhe SN FP-në, sipas rastit, për mbrojtjen e Forcës së tij.

Neni 9

Siguria dhe deklarimi i informacionit

9.1 Pjesëmarrësit dhe SN-të përmbushin procedurat e NATO-s për sigurinë në ruajtjen, trajtimin, transmetimin dhe garantimin e të gjithë materialit të klasifikuar që mbahet, përdoret, gjenerohet, ofrohet ose shkëmbehet.

9.2 Informacioni i dhënë nga një Pjesëmarrës ose SN një tjetri në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një Pjesëmarrës ose SN, i cili kërkon konfidencialitet ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikimi që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklarimit, të barabartë me atë që kërkohet nga Pjesëmarrësi ose SN-ja.

9.3 Çdo Pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjitha hapat e ligjshëm të mundshëm për moszbulimin e të gjithë informacionit të shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur Palët Kontraktuese SN-të bien dakord për këtë deklarim.

9.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo Palë Kontraktuese ose SN e shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim me një legjendë që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklarimit, që informacioni lidhet me një operacion të NATO-s dhe që është dhënë në mirëbesim.

9.5 Vizitat nga personeli do të rregullohen në përputhje me procedurat e specifikuar në C-M(2002)49, i ndryshuar.

Neni 10

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

10.1 Ky MOU hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe me njoftimin e Republikës së Sllovenisë drejtuar Palëve të tjera në lidhje me përmbushjen e të gjitha procedurave ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të këtij MOU-je.

10.2 Të gjitha dispozitat e seksioneve 6, 7 dhe 9 mbeten në fuqi në rastin e tërheqjes së një Pale Kontraktuese ose të përfundimit të këtij MOU-je deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. SN-të përmbushin të gjitha detyrimet në rastin e përfundimit.

Neni 11

Ndryshimi dhe interpretimi

11.1 Ky MOU mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë Palëve.

11.2 Konfliktet e dukshme në interpretimin dhe zbatimin e këtij MOU-je zgjidhen me konsultime ndërmjet Palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk i referohen asnjë gjykate kombëtare ose ndërkombëtare apo pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Secila Palë mund ta prishë këtë MOU me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Prishja e ti hyn në fuqi tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit zyrtar të prishjes.

11.4 Ky MOU është nënshkruar në tre kopje në gjuhën angleze, ku të tre tekstet janë njëllor autentikë.

MOU-ja i mësipërm përfaqëson Marrëveshjen Ndërkombëtare të arritur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Sllovenisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Europë dhe Komandës Supreme Aleate për Transformimin, për çështjet e referuara në të.

NËNSHKRUAR:

Për Qeverinë e Republikës së Sllovenisë

(firmë dhe vulë)

Dr. Ljubica Jelusic
Ministër i Mbrojtjes

Datë 17/05/2010, Ljubljana, Slloveni



Në emër të Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropës dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin

(firmë)

Karl-Heinz Lather
Gjeneral, DEU A
Shef Shtabi
Datë 14 korrik 2010
Mons, Belgjikë

ANEKSE

A. Dokumente reference

B. Notë aderimi (NOA)/Deklarim Synimi (SOI).

ANEKSI A

PËR MOU DATË 10 QERSHOR

DOKUMENTET REFERUESE

a) Traktati i Atlantikut të Veriut i datës 4 prill 1949

b) Dokumenti Kuadër i Partneritetit për Paqe i nxjerrë nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive që merrnin pjesë në Mbledhjen e Këshillit të Atlantikut të Veriut (Dokument Kuadër), datë 10 janar 1994

c) Marrëveshje ndërmjet Palëve të Traktatit Atlantik të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) e datës 19 qershor 1951

d) Marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit Atlantik të Veriut dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin Forcave të tyre (PfP SOFA), e datës 19 qershor 1995

e) Protokollit tjetër Shtesë i Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokollit Tjetër Shtesë), datë 19 dhjetor 1997

f) Protokollit mbi Statusin e Shteteve Ushtarake Ndërkombëtare të krijuara në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut (Protokollit i Parisit), i datës 28 gusht 1952

g) MC 319/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për logjistikën

h) MC 334/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për mbështetjen e Shtetit Pritës (HNS).

i) NATO STANAG-e të zbatueshme dhe Direktivat Politike për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcës dhe Rimbursimin Financiar

j) AJP-4.5 – Publikim i Përbashkët i Aleatëve për Doktrinën dhe Procedurat e Mbështetjes së Shtetit Pritës

k) C-M (2002) 50 – Masat Mbrojtëse për Organet Civile dhe Ushtarake të NATO-s, Forcat dhe Njësitë (Asetet) e Angazhuara të NATO-s kundër Kërcënimeve Terroriste

l) BI-SC Direktiva e Mbrojtjes së Forcës 80-25, 1 janar 2003

m) Bi-SC Udhëzim Planifikimi Funkcional për Mbrojtjen e Forcës

n) AAP-6-Fjalori i termave

o) C-M(2002) 49, Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut

ANEKSI B

PËRMOU DATË 10 QERSHOR

MODEL NOTE PRANIMI (NOA) / DEKLARIM SYNIMI (SOI) PËR PJESËMARRJE NË MBËSHËTETJEN E SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË FINANCIARE DHE TË TJERA TË CAKTUARA BRENDA REPUBLIKËS SË SLOVENISË PËR OPERACIONIN/ STËRVITJEN _____

Republika/Mbretëria/Qeveria/Ministri i
(SN)

i përfaqësuar nga

Pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në Operacion/Stërvitje

Duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërvitjes së NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s,

Me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së Sllovenisë, Komanda e NATO-s (vendos emërtimin e duhur) dhe Shtetet e tjerë Dërgues në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë operacionit/ Stërvitjes,



ZGJEDH TË MARRË PJESE DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E PËRFSHIRA NË:

“Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet (HN) Komanda e NATO-s (vendos emërtimin e dubur) në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë Operacionit/Stërviutjes, që ka hyrë në fuqi më si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për planifikimin, përgatitjen e Operacionit/Stërviutjes (dhe kryerjen e stërviutjes) nëpërmjet MOU-së së sipërpërmendur. (Nëse duhet të shprehen rezerva, mund të shtohen fjalët e mëposhtme në fjali: “në përputhje me rezervat e mëposhtme:” më pas rezervat renditen, sipas rasis).

Për Qeverinë e (SN)

Datë:

Shënim. kjo pjesë është e nevojshme vetëm nëse SN-ja i jep SOI-së rezerva. Atëherë HN-ja duhet të bjerë dakord me ato rezerva duke nënshkruar SOI-në dhe duke ia kthyer SN-së për konfirmim.

Shteti Pritës jep / nuk jep mbështetje për Forcat e Armatosura të Qeverisë së (SN) që marrin pjesë në operacion/stërviutje sipas dispozitave të HNS MOU dhe rezervave të (SN)

Për Republikën e Sllovenisë

Datë:

NATO E PAKLASIFIKUAR

SHTOJCË 1

PËR SH/SAGLE/AM0416-312357

DATË 21 JANAR 16

NOTË PRANIMI

NOTË PRANIMI / DEKLARATË SYNIMI
PËR PJESEMARRJE NË MBËSHTEJTJEN E
SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË
FINANCIARE DHE TË TJERA TË
CAKTUARA BRENDA REPUBLIKËS/
MBRETËRISË SË _____ (HN) PËR
OPERACIONIN/STËRVITJEN _____

Republika/Mbretëria/Qeveria/Ministri i.....(SN)
i përfaqësuar nga

Pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në Stërviutje dhe /ose Operacionet në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë të miratuar nga Këshilli Atlantik të Veriut.

Duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërviutjes së NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s,

Me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së(Shteti Pritës), Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtetet e tjerë Dërgues në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë Stërviutjeve dhe Operacioneve në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë.

ZGJEDH TË MARRË PJESE DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E PËRFSHIRA NË:

“Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet (HN) Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë Operacionit/Stërviutjes, që ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit të fundit si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për aktivitetet ushtarake në lidhje me sipërmarrjet për Planin e Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së së përmendur më sipër.

Për Qeverinë e (SN)

Datë:

NATO E PAKLASIFIKUAR



VENDIM
Nr. 124, datë 22.2 2017

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
PORTUGALISË, SHTABIT SUPREM TË
FUQIVE ALEATE NË EVROPË DHE
SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME
ALEATE PËR TRANSFORMIMIN, NË
LIDHJE ME MBËSHTETJEN E SHTETIT
PRITËS PËR KRYERJEN E
OPERACIONEVE/STËRVITJEVE TË
NATO-S, DHE TË NOTËS SË PRANIMIT
PËR TË BËRË PJESË E KËTIJ
MEMORANDUMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Portugalisë, Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve/stërvitjeve të NATO-s, dhe të notës së pranimit për t’u bërë pjesë e këtij memorandum, sipas tekstit bashkë-lidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BASHKËLIDHJE 12
PËR SH/SALEG/AM/04/16-312357
DATË 21 JANAR 2016

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI (MOU)
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
PORTUGALISË DHE SHTABIT SUPREM TË
FUQIVE ALEATE NË EVROPË DHE
SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME
ALEATE PËR TRANSFORMIMIN NË
LIDHJE ME MBËSHTETJEN E SHTETIT
PRITËS PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE
/STËRVITJEVE TË NATO-S**

HYRJE

Qeveria e Republikës së Portugalisë, e përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Shtabi Suprem i Fuqive Aleatëve në Evropë (SHAPE) dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT), më poshtë të referuar si Pjesëmarrësit:

Duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949, dhe veçanërisht nenin 3 të saj;

Duke pasur parasysh Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe të lëshuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive Pjesëmarrëse në Mbledhjen e Këshillit të Atlantikut të Veriut (Dokumenti Kuadër) të datës 10 janar 1994;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes Ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të Tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (PfP SOFA) të datës 19 qershor 1995 dhe duke përfshirë Protokollin Shtesë të kësaj Marrëveshjeje të datës 19 qershor 1995;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin Atlantik të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951;

Duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtar të krijuar në bazë të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokollit i Parisit) të datës 28 gusht 1952;

Duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit Tjetër Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (Protokollit Tjetër Shtesë), të datës 19 dhjetor 1997;



Duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën dhe kontrollin e NATO-s ose nëpër-mjet territorit të Republikës së Portugalisë gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të operacioneve të NATO-s;

Duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve që parashikohen të ndodhin me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO; dhe

Duke marrë parasysh nevojat e Republikës së Portugalisë që më poshtë referohet si Shteti Pritës, dhe nevojat e Komandës Supreme e Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT), më poshtë të referuara si Komanda Strategjike;

PJESËMARRËSIT KANË ARRITUR MIRËKUPËTIMIN E MËPOSHTËM:

SEKSIONI I PARË

PËRKUFIZIME

Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve mbështetëse, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 Forcat – Të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO që përfshin të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave siç përkufizohen tek NATO SOFA, Protokollin e Parisit dhe homologët PfP. Termi përfshin gjithashtu të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet dhe municionin si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, duke përfshirë kontraktuesit që dislokojnë ose mbështesin forcën.

1.2 Operacionet e NATO-s – Veprimet ushtarake, duke përfshirë stërvitjen ose kryerjen e misioneve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative të kryera nga forcat; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushate.

1.3 Komandant i NATO-s – Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s – Komandat ose repartet e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Komanda Ndërkombëtare – Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s. Përfshin aktivitetet që mund të jenë detashmente të përkohshme ose njësi të Komandave.

1.6 Komanda Kombëtare – Komandat e forcave kombëtare nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.7 Komanda Shumëkombëshe – Komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Shtete Dërguese (SN) – Ato shtete dhe Komanda ose elementët e tyre që angazhohen në territorin e SP-së në mbështetje të Operacioneve të NATO-s.

1.9 Shteti Pritës (HN) – Republika e Portugalisë.

1.10 Komanda ose Komandantët Strategjikë (KK) –Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR) dhe Komandanti Suprem i Aleatëve për Transformimin (SACT), selitë e të cilëve janë SHAPE dhe HQ SACT, përkatësisht.

1.11 Mbështetja e Shtetit Pritës (HNS)– Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti nga një Shtet Pritës forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë transit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës.

1.12 Mbrojtja e Forcës (FP) – Të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjediseve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

1.13 Shpenzimet – Ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e komandave, forcave kombëtare, shumëkombëshe ose formacioneve të NATO-s. Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve të tij mbështetëse:

a) Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s– Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës.

b) Shpenzime të Përbashkëta – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e Shpenzimeve të Përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjet Teknike dhe/ose Marrëveshjet e Përbashkëta të Zbatimit.



c) Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare – Ato shpenzime që konsiderohen të jenë përgjegjësi e një SP-je të vetëm.

1.14 Financim i Përbashkët i NATO-s – Fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për Shpenzimet e Zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të Operacioneve ose Stërviujeve të specifikuara në të.

1.15 Notë Pranimi (NOA) – Një dokument që tregon synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të këtij MOU-je për një Operacion të specifikuar të drejtuar nga NATO.

1.16 Deklaratë Synimi (SOI) – Një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në sipas dispozitave të kësaj MOU-je, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme apo jo për dhënien e HSN-së.

1.17 Marrëveshje Teknike (TA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe e kësaj MOU-je për një operacion të drejtuar nga NATO. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dispozitat e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-së dhe SN(ve).

1.18 Marrëveshje e Përbashkët Zbatimi (JIA) – Një marrëveshje pasuese dypalëshe që vendos angazhimin ndërmjet palëve në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuara të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose kushtet e pagesës.

1.19 Komiteti Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët të Shtetit Pritës (JHNSSC) – Një komitet i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i bashkë-kryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjithë SN-të, HN-ja dhe Komandanti(ët) e NATO-s takohen për të zhvilluar masat e nevojshme përforcuese në lidhje me HNS-në, si TA-ja dhe JIA(të), sipas rastit.

1.20 Vendet Operacionale – Vendet që ndodhen në territorin e HN-së për qëllimin e mbështetjes operationale dhe/ose logjistike për forcën për operacionet ose Stërviujet e NATO-s. Këto vende janë detashmente të një Komande Strategjike nën komandën e një Komandanti të NATO-s.

1.21 Territori – Është territori i Republikës së Portugalisë, duke përfshirë tokën, hapësirën ajrore

dhe ujërat e brendshme të Republikës së Portugalisë.

1.22 Përveç kur një kuptim specifikohet ndryshe në këtë MOU, zbatohet Fjalori i NATO-s për Termat dhe Përkufizimet (AAP-6).

SEKSIONI I DYTË

QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij MOU-je është krijimi i politikës dhe procedurave për përcaktimin e vendeve operationale dhe ofrimin e HNS-së tek forcat e NATO-s, ose të mbështetur nga HN-ja gjatë Operacioneve të NATO-s.

2.2 Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga autoriteti përkatës i HN-së dhe nga Komandantët e NATO-s duke parashikuar masat e HNS-së për një sërë operationesh të NATO-s. Ky MOU zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha operacionet dhe stërviujet. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI I TRETË

OBJEKTI DHE MASA TË PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO ose PpP SOFA, Protokollit të Parisit, Protokollit Tjetër Shtesë dhe çdo Marrëveshje tjetër përkatëse që mund të jenë në fuqi ndërmjet SC-ve dhe HN-së zbatohen për të gjitha operacionet e NATO-s.

3.2 HN-ja njih vendet operationale të ngritura sipas këtij MOU-je si detashmente të SC-së krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmenteve si sipërmarrje të SC-së. Vendet që duhet të vendosen, identifikohen në dokumente pasuese. Masat e komandës dhe kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operationale ose stërviute.

3.3 Ky MOU synon të jetë në përputhje me doktrinën dhe politikën e NATO-s dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për HNS-në.

3.4 HN-ja do të japë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin, për forcat e dislokuara në Operacionet e NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë.

3.5 Dispozitat e këtij MOU-je zbatohen në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti ose



periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të përcaktohet reciprokisht nga HN-ja dhe Autoritetet përkatëse të NATO-s.

3.6 Ndërsa SN-të dërguese inkurajohen të marrin pjesë në operacionet e NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je, si një dokument ombrellë sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja, marrëveshjet e veçanta bilaterale me shtetet individuale mund të merren parasysh nga HN-ja rast pas rasti.

3.7 HN-ja dhe SC-të mund të caktojnë përfaqësues për të negociuar dokumentet që mbështesin dhe zhvillojnë më tej këtë MOU.

3.8 Operacionet e NATO-s të mbështetura nga ky MOU mund të kërkojnë operacione ajrore të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja pranon që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre në dhe përmes zonave territoriale të HN-së do të bëhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e Operacionit. HN-ja do të administrojë/kontrollojë të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.

3.9 Ky MOU synohet të jetë në harmoni me të drejtën e HN-së dhe me çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare që mund të zbatohet.

SEKSIONI I KATËRT

DOKUMENTET REFERUESE

Dokumentet referuese që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU ndodhen në Aneksin A.

SEKSIONI I PESTË

PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij MOU-je

5.1 Shteti Pritës

a) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse dhe me ndodhjen e ndryshimeve dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja bën njoftim në kohën e duhur për Komandantin e NATO-s në lidhje me disponibilitetin ose ndonjë mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s bazohen tek dokumentet mbështetëse të përgatitura për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

b) Me qëllim që të jepet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja e siguruar me prokurim sigurohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues nga ofertuesi më i ulët i përshtatshëm.

c) HN-ja mban regjistrat administrativë dhe financiarë të nevojshme për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohen për NATO-n, siç kërkohet nga qëllimet e auditimit.

d) Standardet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në përputhje me hollësitë e përcaktuara në dokumentet mbështetëse të këtij MOU-je.

e) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) HN-ja do të ofrojë, para çdo operacioni të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HN-së.

g) HN-ja do të ftojë SN-të të pranojnë dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një Note Pranimi ose Deklarimi Synimi.

h) HN-ja parashikon procedurat për lidhjet mjekësore ndërmjet HN-së dhe SN-së, duke përfshirë POC-të mjekësore.

i) HN-ja, (në bashkërendim me Komandantin e NATO-s), i jep forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/mjediset ushtarake të HN-së sipas të njëjta kushteve që u jep ushtarakëve të HN-së.

j) Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse dhe pasuese, HN-ja do t'i japë Komandantit të NATO-s dhe SN-ve kopje të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie dhe mjedisore dhe bujqësore, që mund të zbatohet për Operacionin e NATO-s të zhvilluara në përputhje me këtë MOU, si dhe çdo rregulloreje në lidhje me ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme dhe municioneve.

k) HN-ja pranon që kopjet e listave të mallrave SN të pajisjeve dhe furnizimeve për përdorim ushtarak dhe personal në përputhje me NATO SOFA do të jenë të mjaftueshme për qëllimet doganore.

5.2 Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet



mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe forcës që përcaktohet për një Plan Operacional (OPLAN), një Urdhër Operacional (OPORD) ose një Urdhër Operacional Stërvitor (EXOPORD) nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s i dërgon HN-së njoftim në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe propozon ndryshimin e dokumenteve mbështetëse, sipas rastit.

c) Komandanti i NATO-s përcakton nëse ofrohet Financimi i Zakonshëm dhe cilat kërkesa janë të përshtatshme për Financim të Zakonshëm.

d) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara të HNS-së dhe aprovon Shpenzimet e Zakonshme.

e) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga Financimi i Zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon në masën që është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve.

f) Nëse kërkesat e SN-ve janë në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira.

g) Komandanti i NATO-s identifikon personelin dhe kërkesat e tjera për vendet operacionale që caktohen në HN.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose tek JHNSSC-ja.

5.3 Shtetet Dërguese

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në duke pranuar dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një NOA-je ose duke nxjerrë një SOI për një operacion të caktuar të NATO-s.

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-s ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s.

c) Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë

ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga HN-ja, përveç kur përdoren, siç është rënë dakord, procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

d) SN-të do të ofrojnë personel të përshtatshëm të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet.

e) SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave të HNS-së tek HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s kur ato kryhen dhe paraqet kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet.

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja.

g) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat e HN-së për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë që janë identifikuar për vendet operacionale si dhe çdo rregullore të HN-së për ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI I GJASHTË

MASA FINANCIARE

6.1 Me marrëveshje të ndërsjellë dhe/ose konventa ndërkombëtare, aktivitetet e Komandave Ndërkombëtare, vendet operacionale, anijet, avionët ose automjetet në pronësi dhe/ose të kontraktuara nga NATO, POL dhe forcat e ofruara NATO-s janë të përjashtuara nga tatimet, detyrimet, pagesat shtetërore, tarifrat dhe të gjitha pagesat e ngjashme.

6.2 Protokollin e Parisit, Protokollin Tjetër Shtesë dhe e drejta zakonore ndërkombëtare që zbaton imunitetet dhe privilegjet e një Komande Aleate do të zbatohet për çdo Komandë Ndërkombëtare, element ose detashment të komandës që mund të vendosen në HN-në pas zbatimit të një operacioni të drejtuar nga NATO.

6.3 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifrat ose pagesat e ngjashme nuk është e mundur, detyrimet vendosen në një normë minimale por asnjëherë më të lartë se ajo që zbatohet për Forcat e Armatosura të HN-së. Të gjitha shpenzimet duhet të përpunohen me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.



6.4 Transaksionet financiare që përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive në çdo institucion bankar privat ose qeveritar duhet të kryhen pa marrë asnjë pagesë apo tarifë të asnjë lloji në masën që është e mundur.

6.5 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me Financimin e Zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të Operacionit të NATO-s. Të gjitha masat financiare që negociohen paraprakisht duhet të jenë specifike në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin Financim të Zakonshëm nga NATO.

6.6 Dokumentet mbështetëse ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

6.7 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të përballueshme nga Financimi i Zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SC-ja autorizon Financimin e Zakonshëm për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursion HN-në.

6.8 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime mund të identifikohen si Shpenzime të Përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshirë, mund të ndahen në përputhje me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara në TA ose dokumente të tjerë mbështetës.

6.9 Kërkesat për Koston e Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja merr pjesë normalisht në negociata me HNS-në gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në nëse JHNSSC-ja nuk është themeluar. SH-ja bën pagesa direkte për rimbursimin e HNS-së për HN-në vetëm për shërbimet që jepen nga burimet ushtarake përveç kur zbatohen procedura të tjera pagesa siç është rënë dakord. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare dhe civile paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

6.10 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të dhëna nga HN-ja nuk vendosen me një normë më të lartë se ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së, dhe nuk përfshijnë shpenzime të tepërta administrative ose të tjera, por mund të reflektojnë përshtatje për shkak të skeduleve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose faktorëve të ngjashëm. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.

6.11 Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnizuesit tregtarë për furnizime, shërbime ose mbështetje tjetër.

6.12 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të operojnë pa siguracion tregtar.

6.13 HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose SN-së, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë paraprakisht nga një përfaqësues i autorizuar dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk jepet para se SC(të) ose SN(të), sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.

6.14 Nuk është dhënë financimin në lidhje me këtë MOU dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Komandantit të NATO-s ose SN-ve. Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse.

6.15 Caktimi i vendeve operationale në mbështetje të një operacioni të NATO-s nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

6.16 Pajisjet, furnizimet, produktet dhe materialet e importuara përkohësisht në dhe që ekspertoehen nga territori i HN-së në lidhje me një operacion të NATO-s, janë të përjashtuara nga të gjitha detyrimet, taksat dhe tarifatat. Procedurat e tjera doganore do të përcaktohen në përputhje me NATO ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë, sipas rastit.

SEKSIONI I SHTATË

KONSIDERATA JURIDIKE

7.1 Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në përputhje me NATO



ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë.

7.2 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin ose janë në lidhje me ekzekutimin e këtij MOU-je dhe të tipit të mbuluar nga neni VII i NATO SOFA trajtohen në përputhje me dispozitat e NATO ose Pfp SOFA.

7.3 Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen nga HN-ja në përputhje me procedurën e rregullimit të kontratave publike dhe në përputhje me ligjin e HN-së, me rimbursim nga Komanda e NATO-s ose SN-ja, sipas rastit.

SEKSIONI I TETË

MBROJTJA E FORCËS

8.1 FP-ja e plotë dhe efektive planifikohet për Komandën statike të NATO-s, operacionet, trajnimin dhe stërvitjet dhe detajohet në OPLANS, EXPI ose marrëveshjet plotësuese, sipas rastit. FP-ja zbatohet në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në një mënyrë që është në përputhje me NATO / Pfp SOFA. FP-ja nuk kërkohet në asnjë rrethanë të jetë në kundërshtim me NATO Pfp SOFA ose ligjet e HN-së.

8.2 Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

8.3 Sipas rastit, çdo SN është përgjegjës për identifikimin dhe parashikimin e kërkesave dhe kufizimeve të FP-së tek HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.

8.4 Përveç këtyre përgjegjësive të FP-së të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për FP-në, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin e të gjithë elementëve të kërkuar dhe të paraqitur për HN dhe SN FP-në, sipas rastit, për mbrojtjen e Forcës së tij.

SEKSIONI I NËNTË

SIGURIA DHE DEKLARIMI I INFORMACIONIT

9.1 Pjesëmarrësit dhe SN-të përmbushin procedurat e NATO-s për sigurinë në ruajtjen, trajtimin, transmetimin dhe garantimin e të gjithë materialit të klasifikuar që mbahet, përdoret, gjenerohet, ofrohet ose shkëmbehet.

9.2 Informacioni i dhënë nga një Pjesëmarrës ose SN një tjetri në mirëbesim dhe çdo

informacion i tillë i nxjerrë nga një Pjesëmarrës ose SN, i cili kërkon konfidencialitet ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikimi që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklaramit, të barabartë me atë që kërkohet nga Pjesëmarrësi ose SN-ja.

9.3 Çdo Pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjitha hapat e ligjshëm të mundshëm për moszbulimin e të gjithë informacionit të shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur Pjesëmarrësit ose SN-të bien dakord për këtë deklaram.

9.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo pjesëmarrës ose SN e shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim me një legjendë që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklaramit, që informacioni lidhet me një operacion të NATO-s dhe që është dhënë në mirëbesim.

9.5 Vizitat nga personeli do të rregullohen në përputhje me procedurat e specifikuar në C-M(2002)49, i ndryshuar.

9.6 I gjithë informacioni i klasifikuar dhe materialet në përputhje me dispozitat e këtij seksioni do të vazhdojnë të mbrohen edhe në rastin e tërheqjes së një Pjesëmarrësi ose pas prishjes së këtij MOU-je.

SEKSIONI I DHJETË

HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

10.1 Ky MOU hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit dhe mbetet në fuqi përveç kur përfundohet nga një Pjesëmarrës, duke bërë një njoftim me shkrim me afat gjashtë muaj para, drejtuar të gjithë Pjesëmarrësve të tjerë.

10.2 Të gjitha dispozitat e seksioneve 6, 7 dhe 9 mbeten në fuqi në rastin e tërheqjes së një Pjesëmarrësi ose të përfundimit të këtij MOU-je deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. SN-të përmbushin të gjitha detyrimet në rastin e përfundimit.

SEKSIONI I NJËMBËDHJETË

NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI

11.1 Ky MOU mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë Pjesëmarrësve.

11.2 Konfliktet e dukshme në interpretimin dhe zbatimin e këtij MOU-je zgjidhen me konsultime



ndërmjet Palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk i referohen asnjë gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare apo pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Ky MOU është nënshkruar në tre kopje në gjuhën angleze.

11.4 Problemet e përkthimit dhe interpretimit të këtij MOU-je do të zgjidhen sipas versionit në gjuhën angleze.

Sa më sipër përfaqëson marrëveshjet e arritura ndërmjet Qeverisë së Republikës së Portugalisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Europë dhe Komandës Supreme Aleate për Transformimin, për çështjet e referuara në të.

NËNSHKRUAR:

Për Qeverinë e Republikës së Portugalisë

(firmë)

Emri

Titulli/Grada

Datë 16 gusht 05

Në emër të Komandës Supreme të Fuqive Aleate të Evropës dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin

(firmë)

Rainer Schuwirth

Gjeneral, GE A

Shef Shtabi

Datë 3 qershor 05

Mons, Belgjikë

ANEKSI A

(për shembullin e MOU-së)

DOKUMENTET REFERUESE

a) Traktati i Atlantikut të Veriut i datës 4 prill 1949

b) Dokumenti Kuadër i Partneritetit për Paqe i nxjerrë nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive që marrin pjesë në Mbledhjen e Këshillit të Atlantikut të Veriut (Dokument Kuadër), datë 10 janar 1994

c) Marrëveshje ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantik të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) e datës 19 qershor 1951

d) Marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të

tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin Forcave të tyre (PFP SOFA), e datës 19 qershor 1995

e) Protokollin tjetër Shtesë i Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokollin Tjetër Shtesë), datë 19 dhjetor 1997

f) Protokollin mbi Statusin e Shteteve Ushtarake Ndërkombëtare të krijuara në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut (Protokollin i Parisit), i datës 28 gusht 1952

g) MC 319/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për logjistikën

h) MC 334/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për mbështetjen e Shtetit Pritës (HNS).

i) NATO STANAG-e të zbatueshme dhe Direktivat Politike për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcës dhe Rimbursimin Financiar.

j) AJP-4.5 – Publikim i Përbashkët i Aleatëve për Doktrinën dhe Procedurat e Mbështetjes së Shtetit Pritës

k) C-M (2002) 50 – Masat Mbrojtëse për Organet Civile dhe Ushtarake të NATO-s, Forcat dhe Njësitë (Asetet) e Angazhuara të NATO-s kundër Kërcënimeve Terroriste

l) BI-SC Direktiva e Mbrojtjes së Forcës 80-25, 1 janar 2003

m) Bi-SC Udhëzim Planifikimi Funkcional për Mbrojtjen e Forcës

n) AAP-6 – Fjalori i termave

o) C-M(2002) 49, Siguria Brenda Organizatës së Traktatit të Atlantik të Veriut

MODEL NOTE PRANIMI

(NOA)/DEKLARIM SYNIMI (SOI)

NOTË PRANIMI / DEKLARATË SYNIMI
PËR PJESËMARRJE NË MBËSHTETJEN E
SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË
FINANCIARE DHE TË TJERA TË
KAKTUARA BRENDA REPUBLIKËS SË
PORTUGALISË PËR OPERACIONI/
STËRVITJEN _____

Republika/Mbretëria/Qeveria/Ministri i
(SN)

i përfaqësuar nga

Pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura
do të marrin pjesë në Operacion/Stërvitje



Duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërviçjes së NATO/PfP brenda doktrinë së NATO-s,

Me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së(Shteti Pritës), Komanda e NATO-s (vendos emërtimin e duhur) dhe Shtetet e tjerë Dërgues në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë Operacionit / Stërviçjes,

ZGJEDH TË MARRË PJESË DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E PËRFSHIRA NË:

“Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet (HN) Komanda e NATO-s (vendos emërtimin e duhur) në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë Operacionit / Stërviçjes, që ka hyrë në fuqi më si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për Operacionin e NATO-spër planifikimin, përgatitjen dhe pjesëmarrjen nëpërmjet HNS MOU-së. (Nëse duhet të shprehen rezerva, mund të shtohen fjalët e mëposhtme në fjali: “në përputhje me rezervat e mëposhtme:” më pas rezervat renditen, sipas rastit).

Për Qeverinë e (SN)

Datë:

Shënim. Kjo pjesë është e nevojshme vetëm nëse SN-ja i jep SOI-së rezerva. atëherë HN-ja duhet të bjerë dakord me ato rezerva duke nënshkruar SOI-në dhe duke ia kthyer SN-së për konfirmim.

Shteti Pritës jep/nuk jep mbështetje për Forcat e Armatosura të Qeverisë së (SN) që marrin pjesë në operacion/stërviçje sipas dispozitave të HNS MOU dhe rezervave të(SN)

Për Qeverinë e (HN)

Datë:.....

NATO E PAKLASIFIKUAR

SHTOJCË 1

PËR SH/SAGLE/AM0416-312357

DATË 21 JANAR 16

NOTË PRANIMI

NOTË PRANIMI / DEKLARATË SYNIMI
PËR PJESËMARRJE NË MBËSHTETJEN E
SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË
FINANCIARE DHE TË TJERA TË
CAKTUARA BRENDA REPUBLIKËS/
MBRETËRISË SË(HN)
PËR OPERACIONIN/ STËRVIÇJEN.....

Republika/Mbretëria/Qeveria/Ministri i.....
(SN)

i përfaqësuar nga

Pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në Stërviçje dhe/ose Operacionet në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë të miratuar nga Këshilli Atlantik të Veriut.

Duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërviçjes së NATO/PfP brenda doktrinë së NATO-s,

Me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së(Shteti Pritës), Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtetet e tjerë Dërgues në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë Stërviçjeve dhe Operacioneve në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë.

ZGJEDH TË MARRË PJESË DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E PËRFSHIRA NË:

“Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet (HN) Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë Operacionit/Stërviçjes, që ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit të fundit si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për aktivitetet ushtarake në lidhje me sipërmarrjet për Planin e Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së së përmendur më sipër.



Për Qeverinë e (SN)
Datë:

BASHKËLIDHJE 11
PËR SH/SALEG/AM/04/16-312357
DATË 21 JANAR 2016

NATO E PAKLASIFIKUAR

VENDIM

Nr. 125, datë 22.2.2017

**PËR MIRATIMIN E
MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT,
NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË
SË NORVEGJISË, SHTABIT SUPREM TË
FUQIVE ALEATE NË EVROPË DHE
SHTABIT TË KOMANDANTIT SUPREM
TË ALEATËVE TË ATLANTIKUT, NË
LIDHJE ME MBËSHTETJEN E SHTETIT
PRITËS, PËR KRYERJEN E
OPERACIONEVE TË NATO-S, DHE
NOTËS SË PRANIMIT PËR T'U BËRË
PJESË E KËTIJ MEMORANDUMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë, Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandantit Suprem të Aleatëve të Atlantikut, në lidhje me mbështetjen e shtetit pritës, për kryerjen e operacioneve të NATO-s, dhe notës së pranimit për t'u bërë pjesë e këtij memorandum, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI (MOU)
NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË SË
NORVEGJISË DHE SHTABIT SUPREM TË
FUQIVE ALEATE NË EVROPË DHE
SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME TË
ALEATËVE TË ATLANTIKUT NË LIDHJE
ME MBËSHTETJEN E SHTETIT PRITËS PËR
KRYERJEN E OPERACIONEVE TË NATO-S

PREAMBULË

Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë i përfaqësuar nga Shefi i Mbrojtjes (CHOD) dhe Shtabi Suprem i Fuqive Aleatëve në Evropë (SHAPE) dhe Shtabi i Komandës Supreme të Aleatëve të Atlantikut (SACLANT), më poshtë të referuar si Pjesëmarrësit:

Duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949, dhe veçanërisht nenin 3 të saj;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes Ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik të Veriut në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951;

Duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut (Protokoll i Parisit) të datës 28 gusht 1952 dhe Marrëveshjen shtesë ndërmjet Mbretërisë së Norvegjisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë të datës 10 janar 1996 “Mbi kushtet e veçanta të zbatueshme për ngritjen dhe funksionimin në territorin norvegjez të Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare”;

Duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s në ose nëpërmjet territorit norvegjez gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të operacioneve të NATO-s;

Dhe duke marrë parasysh nevojat e Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë, që më poshtë quhet Shteti Pritës, nevojat e Komandave Madhore të NATO-s (MNC), Shtabit Suprem të Fuqive Aleatëve në Evropë dhe Komandës Supreme të Aleatëve të Atlantikut,

pjesëmarrësit kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:



SEKSIONI I PARË

PËRKUFIZIME

1.1 Forcat – Në këtë MOU termi ‘forcat’ përfshin të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO, qoftë Forcë Reaguese, Forcë Kryesore Mbrojtjeje ose një Forcë Përforcuese, që përfshin të gjithë personelin, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave siç përkufizohen tek NATO SOFA dhe Protokollit i Parisit. Termi përfshin gjithashtu të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet dhe municionin dhe rezervat, si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, duke përfshirë kontraktuesit nga jashtë Norvegjisë, që kërkohen për të dislokuar forcën. Ai përfshin forcat që operojnë nën komandën dhe kontrollin e NATO-s ose në mbështetje të operacioneve të NATO-s.

1.2 Operacionet e NATO-s – Veprimet ushtarake, ose kryerja e misioneve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë sulmin, mbrojtjen, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushate. Këto ‘operacione’ do të kryhen nga forcat e drejtuara nga NATO sipas përshkrimit tek paragrafi 1.

1.3 Komandant i NATO-s – Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 Planet e Kontingjencës (COP) – Planet të cilat zhvillohen për operacione të mundshme ku faktorët e planifikimit (p.sh., objekti, forcat, destinacioni, rreziqet, sfera e përgjegjësisë, etj.) janë identifikuar dhe mund të ushtrohen. COP-et bazohen në udhëzimet e aprovuara për planifikimin dhe nxirren me sa më shumë mundësi që të jetë e mundur, duke përfshirë forcën/aftësitë e kërkuara të forcës dhe opsionet e dislokimit të tyre. COP-et shërbejnë si bazë për planifikimin operacional nga shtetet ose shtabet e NATO-s.

1.5 Shtete Dërguese (SN) – Termi ‘Shtete Dërguese’ përfshin ato shtete që dërgojnë forcat e tyre jashtë kufijve të tyre në mbështetje të Operacioneve të NATO-s.

1.6 Shteti Pritës (HN) – Termi “Shteti Pritës” është Mbretëria e Norvegjisë.

1.7 Mbështetja e Shtetit Pritës (HNS) – Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në kohë

paqeje, emergjence, krize dhe konflikti nga një Shtet Pritës forcave dhe organizatave të NATO-s që ndodhen, ose kalojnë transit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës. Baza për një asistencë të tillë janë angazhimet që rrjedhin nga Aleanca e NATO-s ose nga marrëveshjet bilaterale ose multilaterale që janë lidhur ndërmjet Shtetit Pritës, Organizatave të NATO-s dhe Shteteve Dërgues që kanë forca të cilat operojnë në territorin e Shtetit Pritës.

1.8 Shpenzimet – Ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e komandave, forcave ose formacioneve kombëtare, shumëkombëshe. Për qëllimet e këtij MOU-je dhe dokumenteve të tij mbështetëse:

a) Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës.

b) Shpenzime të Përbashkëta – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e Shpenzimeve të Përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në TA-të.

c) Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare – Ato shpenzime që konsiderohen të jenë përgjegjësi e një shteti të vetëm.

1.9 Financim i Përbashkët i NATO-s – Fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s (nëpërmjet SHAPE ose SACLANT) për të mbuluar Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s. Ky financim jepet nga Komitetet e Financimit të NATO-s që veprojnë në emër të Këshillit Atlantik Verior (NAC) nëpërmjet Buxheteve vjetore të Shtabëve, ose Buxheteve të Programit të ngritur specifikisht për një program të caktuar. Kostoja ndahet ndërmjet shteteve të NATO-s në bazë të një formule të rëndë dakord bashkërisht për ndarjen standarde të shpenzimeve.

SEKSIONI I DYTË

QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij MOU-je është krijimi i politikës dhe procedurave për ofrimin e HNS-së tek forcat e NATO-s që dislokohen në Norvegji ose ujërat kufitare sipas zbatimit të MNC COP-ve, ose për të mbështetur trajnimin apo operacionet e rënda dakord të NATO-s.

2.2 Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga Norvegjia dhe nga Komandantët e NATO-s – të



masave të HNS-së për një sërë operacionesh, duke përfshirë stërvitjet the trajnimin, planet e kontigjencës (COPs) dhe koncepte të tjera të përgjithshme të operacioneve. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI I TRETË

OBJEKTI DHE MASA TË PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO SOFA, Protokollit të Parisit, dhe Marrëveshjes Shtesë ndërmjet Mbretërisë së Norvegjisë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë të datës 10 janar 1996 “Mbi kushtet e veçanta të zbatueshme për ngritjen dhe funksionimin në Territorin Norvegjez të Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare” do të zbatohen për të gjitha operacionet sipas këtij MOU-je. Norvegjia njihet MNLC-të/ALSS-të/FLS-të të jenë detashmente të MNC-ve krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmente të jenë sipërmarrje të MNC-së.

3.2 Ky MOU synohet të jetë në përputhje me MC 334 dhe ALP 12, ku MNC-të bien dakord të veprojnë në emër të Shteteve Dërguese në negociimin e një HNS MOU-je. Në rastet kur shtetet dërguese mund të identifikohen, për shembull në mbështetje të një COP-i, MNC-të do të kërkojnë aprovimin e shteteve dërguese për të negociuar MOU-në në emër të tyre. Në rastin kur shtetet dërguese nuk mund të identifikohen, për shembull, për stërvitjet në të ardhmen, ose për një koncept mbështetjeje që është i përgjithshëm në natyrë, MNC-të do të negociojnë MOU-në në emër të shteteve dërguese të panjohur. Menjëherë pas identifikimit të shteteve dërguese, MNC-të do të kërkojnë aderimin e shteteve dërguese në këtë MOU nga shtetet dërguese nëpërmjet nënshkrimit të shtojcës që tregon pranimin e dispozitave që gjenden këtu. MOU-ja ofron një masë ombrellë që parashikon strukturën për hyrjen e shpejtë nga shtetet dërguese.

3.3 HN-ja do të japë mbështetje sipas nevojës, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin, për forcat e dislokuara në Operacionet shumëkombëshe të NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë,

të cilat, kur të përfundohen do t'i shtohen këtij MOU-je.

3.4 Ky MOU synon të jetë në përputhje me ligjin e HN-së dhe me çdo marrëveshje ndërkombëtare që mund të zbatohet.

3.5 Dispozitat e këtij MOU-je zbatohen në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti ose periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të përcaktohet bashkërisht nga Qeveria e Norvegjisë, SHAPE dhe SACLANT.

3.6 Ndërsa Shtetet Dërguese inkurajohen të përdorin këtë MOU si dokumentet përmbledhëse sipas të cilit jepet HNS-ja nga Norvegjia, nëse ekzistojnë marrëveshje të veçanta bilaterale, dhe për këtë bihet dakord nga shteti dërgues dhe Norvegjia, këto mund të përdoren si marrëveshje sipas të cilës Norvegjia i jep HNS-së.

3.7 CHOD Norvegji, SACEUR dhe SACLANT mund të delegojnë, në përputhje me dispozitat e MC 334 dhe ALP-12, autoritetin për të negociuar dokumente që mbështesin dhe fuqizojnë këtë MOU.

3.8 Operacionet mbështetura nga ky MOU mund të kërkojnë operacione ajrore të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja pranon që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre do të bëhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e Operacionit. HN-ja do të administrojë/kontrolojë të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.

SEKSIONI I KATËRT

DOKUMENTET REFERUESE

Dokumentet që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU ndodhen në Aneksin A.

SEKSIONI I PESTË

PËRGJEGJËSITË

5.1 Norvegjia si Shteti Pritës, brenda dispozitave të këtij MOU-je:

5.1.1 HN-ja do të japë mbështetje siç detajohet në dokumentet mbështetëse të këtij MOU-je. Mangësitë dhe shkallën ose tipin e mbështetjes së pritur gjatë zbatimit praktik të mbështetjes së planifikuar do të identifikohen gjatë diskutimeve.

5.1.2 Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse të këtij MOU-je dhe me ndodhjen e



ndryshimeve dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja bën njoftim për MNC-të në lidhje me disponibilitetin e aftësive të HNS-së dhe paraqet raporte. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s bazohen tek dokumentet mbështetëse të përgatitura për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

5.1.3 Me qëllim që të jepet mbështetja e pranuar, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare.

5.1.4 HN-ja mban regjistrat administrativë dhe financiarë të nevojshme për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat.

5.1.5 Standardet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në përputhje me hollësitë e përcaktuara në dokumentet mbështetëse të këtij MOU-je.

5.1.6 HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

5.1.7 Gjatë përgatitjes së dokumenteve mbështetëse, HN-ja do t'u japë MNC-ve kopje të çdo rregulloreje mjedisore, që mund të zbatohet për Operacionin sipas këtij MOU-je, si dhe çdo rregulloreje në lidhje me ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme ose municionit.

5.1.8 Norvegjia pranon që kopjet e listave të mallrave të Shteteve Dërguese për pajisje dhe furnizimet, për përdorim ushtarak dhe personal në përputhje me NATO SOFA, do të jenë të mjaftueshme për dokumentim për qëllimet doganore.

5.2 MNC-të (ose Komandanti i caktuar i NATO-s)

5.2.1 MNC-të garantojnë, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe forcës dhe Shtetet Dërguese që përcaktohen në një Urdhër Operacional (OPORD) që zbatojnë një plan të përgjithshëm nuk mund të specifikohet para kohe. MNC-ja jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.

5.2.2 MNC-të dërgojnë HN-së njoftim në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe

propozon ndryshimin e dokumenteve mbështetëse, sipas rastit.

5.2.3 MNC-të përcaktojnë dhe vendosin prioritetet për Mbështetjen e kërkuar të HN-së dhe aprovojnë çmimet për shpenzimet e Zakonshme. Në rastin e kërkesave kontradiktore, prioritetet përcaktohen në përputhje me MC 36/2 (që ndryshohet herë pas here).

5.2.4 MNC-të garantojnë rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rena dakord, nëse paguhet nga Financimi i Zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, MNC-të ndihmojnë në masën që është e nevojshme për zgjidhjen e konsideratave financiare ndërmjet HN-së dhe Shteteve Dërguese.

5.2.5 MNC-të ftojnë Shtetet Dërguese për t'u bërë pjesëmarrës në këtë MOU.

5.3 Shtetet Dërguese. Brenda dispozitave të këtij MOU-je:

5.3.1 Shtetet Dërguese mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për mbështetjen e centralizuar logjistike duke pranuar dispozitat e këtij MOU-je nëpërmjet një MJCL/MNCL/ALSS/FLS-je.

5.3.2 Shtetet Dërguese identifikojnë kërkesat e HNS-s ndaj MNC-së përgjegjëse. MNC-ja përcakton nëse ofrohet financimi i Zakonshëm dhe cilat janë kërkesat e përshtatshme për financim nga Shpenzimet e Zakonshme ose shpenzimet Kombëtare të Drejtpërdrejta. Nëse kërkesat e Shteteve Dërguese (qofshin si Shpenzime të Zakonshme apo Shpenzime Kombëtare të Drejtpërdrejta) janë në kundërshtim me prioritetet e shpërndarjes së burimeve nga MNC-ja, MNC-ja do të zgjidhe konfliktin me Shtetet Dërgues përkatëse.

5.3.3 Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, Shteti Dërgues normalisht merr pjesë në negociatat për çmimet drejtpërdrejt me HN-në, dhe ofron pagesën e drejtpërdrejtë. MNC-ja lehtëson standardizimin.

5.3.4 Si një tipar i përgjithshëm i planifikimit për pjesëmarrjen e Shtetit Dërgues në plane ose për pjesëmarrjen gjatë kohëzgjatjes së operacionit të NATO-s, Shtetet Dërgues të mundshëm ose të identifikuar ftohen të kontribuojnë për dokumentet mbështetëse në këtë MOU me evoluimin e procedurave zbatuese.

5.3.5 Në masën e mundur dhe brenda kufizimeve të rrethanave mbizotëruese, Shtetet Dërguese ftohen të marrin pjesë në diskutimet paraprake për kërkesat.



5.3.6 Shtetet Dërguese do të raportojnë ndryshimet e kërkesave të HNS-së tek MNC-ja dhe kur ato kryhen dhe i paraqet HNS-së kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet siç kërkohet.

5.3.7 Shtetet Dërguese duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat për mjedisin që mund të jenë të zbatueshme për ALSS-në/FLS-në, si dhe çdo rregullore për ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme ose municioneve.

SEKSIONI I GJASHTË

MASA FINANCIARE (Shih përkufizimet financiare në seksionin 1)

6.1 Aktivitetet e Komandave të NATO-s, bazave logjistike, forcave kombëtare ose shumëkombëshe dhe trupave individuale që i ofrohen NATO-s janë, me marrëveshje të ndërsjellë janë të përjashtuara nga të gjitha tatimet, tarifatat dhe të gjitha pagesat e ngjashme, në masën maksimale të mundshme, mundësisht nën kujdesin e masave para-ekzistuese të zbatimit SHAPE/Vend Pritës për NATO SOFA. Masat dhe praktikatat që janë në fuqi të cilat zbatohen imunitetet dhe privilegjet në lidhje me Komandat e Aleatëve në Norvegji, do të zbatohen për çdo Komandë ose bazë logjistike të NATO-s, që mund të vendosen në Norvegji pas zbatimit të një operacioni të mbështetur nga ky MOU.

6.2 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifatat ose pagesat e ngjashme nuk është e mundur, detyrimet vendosen në një normë minimale dhe me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.

6.3 Pjesëmarrësit pranojnë që zhvillimi i masave financiare HNS-ë në mbështetje COP-it do të jetë një proces evolucionar – i cili do të vazhdojë të specifikohet me marrjen e informacionit të mëtejshëm. Pjesëmarrësit vënë re që Financimi i zakonshëm i NATO-s tashmë nuk ekziston për të mbështetur këtë MOU dhe mund të mos jetë i disponueshëm pas një vendimi të NATO-s për të zbatuar operacione në mbështetje të këtij MOU-je.

6.4 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me Financimin e Zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të COP-it. Të gjitha masat financiare që negociohen paraprakisht duhet të jenë specifike në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s.

Shpenzimet për të cilat nuk bëhet specifikisht dakord nga të dy palët që të jenë shpenzime të financuara nga NATO, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin Financim të Zakonshëm nga NATO.

6.5 Dokumentet mbështetëse sipas këtij MOU-je ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

6.6 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të përballueshme nga Financimi i Zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SHAPE ose SACLANT, sipas rastit, autorizon Financimin e Zakonshëm për ato shpenzime dhe përcakton Komandantin e NATO-s që do të rimbursojë drejtpërdrejt Norvegjinë.

6.7 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, por nuk kualifikohen si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s këto shpenzime mund të identifikohen si Shpenzime të Përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshirë, mund të ndahen në përputhje me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara nga këto shtete.

6.8 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake vendosen me të njëjtën normë që vendosen për Qeverinë Norvegjeze, por mund të reflektojnë diferencime në çmim për shkak të skeduleve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose faktorëve të ngjashëm.

6.9 Pretendimet kontraktuale do të përpunohen dhe gjykohen nga Norvegjia nëpërmjet procesit të rregullimit të kontratave publike dhe në përputhje me ligjin norvegjez, me rimbursim nga Komandanti Madhor i NATO-s ose Shteteve Dërguese, sipas rastit.

6.10 Norvegjia nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose Shtetit Dërgues, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk jepet para se SHAPE ose SACLANT, sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.



6.11 Pretendimet që rrjedhin nga, ose në lidhje me zbatimin e këtij MOU-je dhe të tipit të mbuluar nga neni VIII i NATO SOFA do të trajtohet në përputhje me dispozitat e këtij neni.

6.12 Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse të këtij MOU-je.

SEKSIONI I SHTATË

DEKLARIMI I INFORMACIONIT

7.1 Informacioni i dhënë nga një Pjesëmarrës një tjetri në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një Pjesëmarrës në përputhje me këtë MOU, i cili kërkon konfidencialitet ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikim që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklaramit, të barabartë me atë që kërkohet nga Pjesëmarrësi.

7.2 I gjithë informacioni dhe materiali që rrjedh nga seksionet 7 dhe 8 do të vazhdojë të mbrohet në rastin e tërheqjes së një pjesëmarrësi ose pas prishjes së këtij MOU-je.

7.3 Çdo Pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjitha hapat e ligjshëm të mundshëm për moszbulimin e të gjithë informacionit të shkëmbyer në mirëbesim sipas këtij MOU-je, përveç kur pala tjetër bie dakord për këtë deklaram.

7.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo Pjesëmarrës e shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim me një legjendë që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklaramit, që informacioni lidhet me këtë MOU dhe që është dhënë në mirëbesim.

SEKSIONI I TETË

SIGURIA

8.1 Pjesëmarrësit e ruajnë, trajtojnë, transmetojnë dhe garantojnë të gjithë materialin e klasifikuar të mbajtur, përdorur, gjeneruar, dhënë ose shkëmbyer sipas këtij MOU-je në përputhje me dispozitat e C-M (55) 15 (Finale), të datës 1 tetor 1990 “Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior”, të ndryshuar.

8.2 Vizitat nga personeli do të realizohen në përputhje me procedurat e specifikuar në -M (55) 15 (Finale), të ndryshuar.

SEKSIONI I NËNTË

HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

9.1 Ky MOU dhe dokumentet e tij mbështetëse hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit për çdo dokument përkatës. MOU-ja do të mbetet në fuqi për aq kohë sa Norvegjia mbetet palë në Traktatin Atlantik Verior, përveç kur priset më parë duke bërë njoftim gjashtë mujor me shkrim drejtuar pjesëmarrësve të tjerë.

SEKSIONI I DHJETË

NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI

10.1 Ky MOU mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë Palëve.

10.2 Kjo masë synohet të jetë në përputhje me ligjet e HN-së dhe detyrimet e traktatit. Konfliktet e dukshme zgjidhen me bisedime ndërmjet pjesëmarrësve.

10.3 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj mase zgjidhet me konsultime ndërmjet Palëve dhe nuk i referohen asnjë gjykate ndërkombëtare apo pale të tretë për zgjidhje.

SEKSIONI I NJËMBËDHJETË

Sa më sipër përfaqëson Marrëveshjet e arritura ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë, Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Europë dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate Atlantike, për çështjet e referuara në të.

Nënshkruar në tre kopje zyrtare në gjuhën angleze.

Për Ministrin e Mbrojtjes së Mbretërisë së Norvegjisë

(firmë)

L. REVANG

Nënadmiral/Shtabi, Komanda e Mbrojtjes, Norvegji

Datë 4 korrik 1997

Për Komandantin Suprem të Aleatëve të Atlantikut

(firmë)



Merrill W. Ruck
Kundëradmiral, Forca Detare e SHBA-së
Shef Shtabi

Për Komandantin Suprem të Aleatëve të Atlantikut
Datë 16 maj 1997
Norfolk, VA

Për Komandën Supreme të Fuqive Aleate në Europë

(firmë)

Charles R. Heflebower
Gjeneral Major, USAF
Asistent i Shefit të Operacioneve të Shtabit
Mons, Belgjikë
20 qershor 97

ANEKSI A

DOKUMENTET REFERUESE

1. Traktati Atlantik i Veriut i nënshkruar në Uashington DC, më 4 prill 1949

2. Marrëveshje në Lidhje me Statusin e Forcave të NATO-s, nënshkruar në Londër, e datës 19 qershor 1951 'NATO SOFA'

3. Protokollin mbi Statusin e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare të krijuara në përputhje me Traktatin Atlantik të Veriut, të nënshkruar në Paris, më 28 gusht 1952, i referuar shkurtimisht si "Protokollin i Parisit"

4. MC 36/2 – Ndarja e Përgjegjësiave në Kohë Luftë Ndërmjet Komandantëve Kombëtarë dhe Komandantëve Madhorë të Varur të Aleatëve

5. MC 317/1 – Struktura e Forcës së NATO-s

6. MC 319/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për logjistikën

7. MC 326 – Parimet dhe udhëzime për mbështetjen mjekësore për NATO-n

8. MC 334/1 – Parimet dhe politikat e NATO-s për Planifikimin e Mbështetjes së Shtetit Pritës (HNS)

9. MC 336 – Koncepti i NATO-s për Menaxhimin e Lëvizjes, Transportimit dhe Lëvizshmërisë

10. MC 400/2 – Udhëzim MC për Zbatimin Ushtarak të Konceptit Strategjik të Aleancës

11. NATO STANAG-e dhe Direktivat e zbatueshme për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcës dhe Rimbursimin Financiar

12. Koncepti i NATO-s për operacionet detare (CONMAROPS)

13. ALP – 11, Logjistika e Forcës Detare Shumëkombëshe

14. ALP-12, Udhëzim për Planifikimin dhe Përgatitjen e Marrëveshjeve/Masave për Mbështetjen e Shtetit Pritës (HNSA)

15. AAP-6-Fjalori i termave

16. Udhëzues Planifikimi funksional (Operacione Detare PROJEKT)

17. Direktiva BI-MNC, Procedurat për Planifikimin e Mbështetjes së Shtetit Pritës për NATO-n për Operacionet e Përgjithshme dhe Shumëkombëshe (projekti i katërt)

18. C-M(55) 15, Siguria Brenda Organizatës së Traktatit Atlantik të Veriut

19. SHAPE COP 10403 – ROJA KUFTTARE

20. CINCNORTHWEST COP 20403 – BRIGHTGRANITE

NATO E PAKLASIFIKUAR

SHTOJCË 1

PËR SH/SAGLE/AM0416-312357

DATË 21 JANAR 16

NOTË PRANIMI

NOTË PRANIMI / DEKLARATË SYNIMI
PËR PJESËMARRJE NË MBËSHTETJEN E
SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË
FINANCIARE DHE TË TJERA TË
CAKTUARA BRENDA REPUBLIKËS/
MBRETËRISË SË _____(HN)
PËR OPERACIONIN/STËRVITJEN_____

Republika/Mbretëria/Qeveria/Ministri i.....
(SN)

i përfaqësuar nga

Pasi ka vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të marrin pjesë në Stërvitje dhe/ose Operacionet në lidhje me aktivitetet në lidhje me planin e veprimit të gatishmërisë të miratuar nga Këshilli Atlantik të Veriut.

Duke marrë parasysh konceptin e përgjithshëm të operacionit/stërvitjes së NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s,

Me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së (Shteti Pritës), Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në



Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtetet e tjerë Dërgues në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë Stërvitjeve dhe Operacioneve në lidhje me aktivitetet në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë.

ZGJEDH TË MARRË PJESE DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E PËRFSHIRA NË:

“Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet (HN) Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme

Aleate për Transformimin (HQ SACT) në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë Operacionit/Stërvitjes, që ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit të fundit si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për aktivitetet ushtarake në lidhje me sipërmarrjet për Planin e Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së së përmendur më sipër.

Për Qeverinë e (SN)

Datë:

NATO E PAKLASIFIKUAR

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 336 lekë